



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK  
VENDIM

Nr. 83 datë 16/11/2022

MBI

**“MIRATIMIN PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT "DOKTOR" NË ARTE PAMORE, TË PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI PIKTURË, PRANË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 79 të ligjit nr. 80/2015, për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të MASR nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, në nenin 24, pika 1, gërma j të Statutit të Universitetit të Arteve, pasi shqyrtoi dhe diskutoi dokumentacion e paraqitur nga Fakulteti i Arteve të Bukura me nr. 167 prot., me votim të hapur unanimisht,

**VENDOSI**

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve "Doktor" në Arte Pamore, të paraqitur nga Departamenti Pikturë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim si dhe dokumentacioni i dërguar nga Fakulteti i Arteve të Bukura me nr. 167 prot., datë 14.11.2022, t'i dërgohet për miratim paraprak Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve. Pas miratimit nga BA, të ngarkohet brenda datës së afatit të përcaktuar në platformën e-Albania nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë "Pikturë".
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Dr. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

Erlind FUSHA (Student FAB)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANI

Nr. 167 prot.

Tiranë, më 24.11.2022

Lënda: Mbi marrëveshjen e Profesorëve që do të udhëheqin “Doktorurat” në FAB.

Profesorët e mëposhtëm, personeli akademik i FAB si dhe kolegë të tjerë të ftuar në Fakultetin e Arteve të Bukura japin miratimin e tyre për të udhëhequr Doktorurat, nëse do të realizohet hapja e tyre. Emrat e tyre janë si më poshtë:

Prof. Gazmend Leka \_\_\_\_\_

Prof. Najada Hamza \_\_\_\_\_

Prof. Vladimir Myrtezai \_\_\_\_\_

Prof. Sadik Spahija \_\_\_\_\_

Prof. Artan Peqini \_\_\_\_\_

Prof. Asc. Dr. Ardian Isufi \_\_\_\_\_

Prof. Asc. Dr. Anila Mullahi \_\_\_\_\_

Prof. Asc. Edmond Gjipopulli \_\_\_\_\_

Prof. Asc. Albes Fusha \_\_\_\_\_

PROF. ARTAN PEQINI

DEKAN

FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA



REPUBLIKAE SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANATI

Nr. 1677 Prot.

Tiranë, më 14.11. 2022

I ënda Propozim për hapjen e Programit të Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore

**Drejtuar: Profesor Kastriot Çausi**  
**Rektor i UART**

**Prof. Dr. Erald Bakalli**  
**Zv. Rektor i UART**

I nderuar z. Çausi,  
Bashkëgjitur po ju dergojme Propozimin për hapjen e Programit të Ciklit III (Doktoraturë) në  
Arte Pamore, pranë Departamentit Pikturë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

Me konsideratë  
**Prof. Dr. Artan PEQINI**

  
DEKAN I FAB-it





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEPARTAMENTI PIKTURË

Nr. 48 Prot

Tiranë, më 14/11/ 20??

Lënda: Propozim për hapjen e Programit të Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Arteve të Bukura

**Prof. Artan PEQINI**

**Universiteti i Arteve  
Sheshi Nënë Tereza**

I nderuar z. Peqini,

Në lidhje me aplikimin e Njesisë Bazë Pikturë për hapjen e Programit të Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore, mbështetur në Udhezimin Nr. 7, date 31.3.2021 Për disa ndryshime të Udhezimit Nr. I, date 14.1.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të arsimit të Lartë*" i ndryshuar, pika. 3, gërma. a, po ju paraqes propozimin e Njesisë Bazë për hapjen e Programit të Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEPARTAMENTI PIKTURË

**1. Argumenti për hapjen e Programit të Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore**

UART është i vetmi Universitet në Shqipëri me dy cikle të plota studimi, Bachelor në Arte Pamore, Master në Arte pamore, e cila ka disa njësi bazë që i dedikohen Njësie Kryesore të këtij Universiteti ku bën pjesë edhe Fakulteti i Arteve Pamore. Në këtë kontekst, nevoja për të patur profesionistë të aftë që t'i përgjigjen këtij realiteti do të sigurohet nga programi i studimit Doktoraturë në Arte Pamore i FAB.

Programi i Ciklit të Tretë i studimit “Doktor në Arte Pamore” do të ofrohet nga Njësia kryesore / Fakulteti i Arteve të Bukura (FAB), i cili është një prej tri fakulteteve të UART. Njësia bazë (departamenti i Pikturës ) do të drejtojë këtë program studimi në bashkëpunim me dy njësitë e tjera Arte të Aplikuara dhe Skulpturë.

Programi ndërtohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat e përcaktuara në bazë të drejtimeve: a) Arte të aplikuara; b) Pikturë; c) Skulpturë. Studentët e këtij programi doktoral janë strategjikisht të rëndësishëm për zhvillimin e cilësisë së përgjithshme akademike të FAB. Kohëzgjatja e këtij programi studimi është jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike.

Programi i Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore vjen si një nevojë e kahershme e plotësimit të ciklit edukativ akademik në fushën e arteve pamore në Shqipëri. Prej shumë vitesh tashmë, kjo nevojë ka qenë e pranishme, e lidhur ngushtë me mungesën e kërkimit shkencor, kritikës, ekspertizës profesionale dhe, në përgjithësi, rritjes së nivelit akademik dhe shkencor të stafit mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Bukura.

Programi i Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore, është krijuar për të fuqizuar akademikët dhe profesionistët e angazhuar në fushat e kërkimeve shkencore akademike, të përqendruar në çështjet që lidhen me lëmin e: arteve të aplikuara, pikturës dhe skulpturës. Ky program



studimi kërkon të sigurojë studime të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e fenomeneve artistike në Artet Pamore, për t'i përgatitur studentët për avancim akademik, kërkimor, si dhe karrierë të avancuar profesionale. Përfundimi me sukses i gradës shkencore “Doktor në Arte Pamore” kërkon nga çdo doktorant realizimin e një marrëdhënie të sofistikuar me dijen dhe kujdesin për krijimin e një identiteti intelektual. Në përfundim, studentët janë të aftë të identifikojnë një traditë specifike të kërkimit shkencor dhe artistik, si metodë kërkuese që përputhet me angazhimet e tyre.

Plotësimi i tre cikleve të studimit në Universitetin e Arteve është, në radhë të parë, një domosdoshmëri e kërkuar qartë nga ligji i MASR për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Shqipëri. Kjo gjë vërehet edhe në fushën e arteve pamore ku mungojnë kritikët e artit, kuratorët, gazetarët e kulturës dhe studiuesit e artit në përgjithësi, duke krijuar një boshllëk të konsiderueshëm në studimin e fenomeneve të reja prezente në këtë fushë, por edhe në evidentimin dhe adresimin me nivel profesional dhe shkencor të momenteve të ndryshme të zhvillimit të artit shqiptar historikisht. Gjithashtu ndjehet një mangësi në botimet shkencore, monografite apo studimet e problematikave të reja bashkëkohore mbi zhvillimet në skenën bashkëkohore të arteve pamore në Shqipëri.

Kjo kërkesë për hapjen e Programit të Doktoraturës në FAB të UART, bazohet në disa parime strategjike dhe në disa modele për organizimin e programeve të doktoraturës nga universitetet e artit në Europë dhe SHBA. Ndryshueshmëria në insitucional të universiteteve të artit ndikon që zbatimi i programeve të doktoraturës në fushën e arteve t'i nënshtrohet proceseve dhe normave rregulluese të ndryshme. Disa vende si, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Suedia, Spanja, kanë dhjetë ose më shumë vite përvojë në dhënien e gradave të doktoraturës në fushën e arteve. Ndërsa vende të tjera kanë filluar të prezantojnë studimet e doktoraturës, vetëm gjatë viteve të fundit. Meqenëse legjislacioni i shteteve të ndryshme ka ndryshime në lidhje me procedurën e hapjes së programeve të studimeve kërkimore të doktoraturës në fushën e arteve, skulpturës dhe *art design*-it, mund të flitet sot për një Evropë me shpejtësi të ndryshme në këtë drejtim. Gjithashtu, disa vende kanë futur programet e doktoraturës në fushën e artit, si pjesë e programeve studimore bashkëpunuese me universitete shkencore, si p.sh.: Zvicra dhe, pjesërisht, Belgjika.

Universitetet e artit kanë qenë në gjendje të implementojnë programet e doktoraturave artistike si një e drejtë e tyre, pa pasur nevoja për bashkëpunim (Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Finlanda, Austria, Republika Çeke).



Diskutimet rreth doktorave në fushën e arteve, të udhëhequra nga universitetet e artit apo dhe organizata të tjera, kanë treguar, pavarësisht dallimeve strukturore, se ka një motivim në rritje për të ofruar programe doktorature në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Kjo rritje e motivimit përkon deri në një farë mase, me zhvillimin masiv në disiplinat artistike të kërkimit shkencor artistik brenda fushave të artit. Ndhimesa për menaxhimin e kësaj prirje motivuese drejt kërkimit në doktoraturat në fushën e arteve organizohet nga disa organizata ndërkombëtare me fokus hulumtimin artistik në mbarë Evropën. Të tilla janë p.sh. Rrjeti Evropian i Kërkimeve Artistike (EARN), Shoqata për Hulumtime Artistike (SAR), Hulumtimi Artistik i Platformës Europiane në Muzikë (EPARM), etj. Krahas këtyre organizatave ndërkombëtare, ka dhe disa organizata kombëtare që ndihmojnë në këtë drejtim si p.sh.: Platforma për Kërkime Artistike në Suedi (PARSE), apo disa revista që ndikojnë për shpërndarjen e rezultateve të kërkimit artistik, të tilla si p.sh. Revista JAR për Hulumtime Artistike. Kjo veprimtari në funksion të rritjes së kërkimit artistik brenda artit mbështetet nga disa programe financimi për projekte kërkimore artistike si p.sh.: Programi PEEK në Fondet Shkencore Austriake, Programi Norvegjez i Kërkimeve Artistike dhe programi financues për kërkime artistike në Këshillin Suedez të Kërkimeve.

Hapja e programeve të doktoraturës në fushën e arteve pamore në përgjithësi, është formuluar si një pikë referimi për politikbërësit, drejtuesit e universitetit, hartuesit e kurrikulave dhe agjencitë për financimin e kërkimit. Kërkesa për hapje ndihmon universitetet e artit së pari për të siguruar njohje për përpjekjet e tyre me organet kombëtare të financimit, ligjet etj. dhe së dyti i ndihmon për të mësuar rreth nivelit të implementimit të zhvillimit të kërkimit shkencor brenda universiteteve të artit. Inisiativa për të hartuar një program doktorature në fushën e arteve ka ardhur si pasojë edhe e përfshirjes së "kërkimit shkencor artistik" në Manualin e Frascatit të OECD-së. Ajo ka për qëllim formimin e mëtejshëm të të kuptuarit të hulumtimeve në fushën e artit dhe krijimin e kornizave, mjediseve dhe burimeve të nevojshme për pjesmarrësit e programit të doktoraturës, me qëllim zhvillimin e projekteve të tyre. Ky manual bëri të qartë se gjithçka që vlen për hulumtimin dhe hapjen e programeve të doktoraturës në fushën e artit bazohet në disa dokumenta kryesor siç janë: "Rekomandimet e Salzburgut" (2005) organizuar Shoqata Europiane e Universiteteve (EUA) dhe "Trajnimi inovativ i doktoraturës" (Komisioni Evropian), dokumenta ku mbështetet edhe iniciativa për hapjen e këtij programi të parë në fushën e artit në IAL shqiptare.

Programi i Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore vjen gjithashtu edhe si një nevojë e domosdoshme e plotësimit të ciklit edukativ akademik në fushën e arteve pamore në





Shqipëri. Prej shumë vitesh tashmë, kjo nevojë ka qenë e pranishme, e lidhur ngushtë me mungesën e kërkimit shkencor, të kritikës, të ekspertizës profesionale dhe, në përgjithësi, të rritjes së nivelit akademik dhe shkencor të stafit mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Bukura.

## 2. Propozimi

Lidhur sa më sipër Njësia Bazë Pikturë, bazuar në Ligj in Nr. 80, date 22/07/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Neni.79, VKM Nr. 112, date 23. 02. 2018, *Për Përcaktimin e Kritereve për Fitimin e Gradës Shkencore "Doktor" dhe të Standarteve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademike "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"*, ndryshuar me VKM Nr. 808, datë 11.12.2019, Statutin e Universitetit të Arteve, Neni 13, -pika. 6, gërma. b, propozon hapjen e programit të studimeve në Ciklin III për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në Arte Pamore, në bashkëpunim me dy njësitë e tjera të fakultetit, që janë: Njësia Bazë “Arte të Aplikuara” dhe Njësia Bazë “Skulpturë”.

## 3. Objektivat e programit

**Qëllimi i programit** doktoral në Arte Pamore është:

Zhvillimi i aftësive artistike, për gjenerimin e njohurive të reja dhe avancimi në mënyrë të thelluar mbi kërkimet në fushën e arteve pamore, për plotësimin e nevojave të kësaj fushe të krijimtarisë artistike shqiptare me ekspertë, studiues arti dhe kritikë arti, me praktika krijuese bashkëkohore artistike, si dhe staf akademik e mësimdhënës, duke u thelluar në studimin e fenomeneve artistike bashkëkohore shqiptare, krijuesve dhe lidhjen e tyre në një kontekst global me zhvillimet artistike të kohës.

Për të përmbushur këtë qëllim, programi i ciklit të III-të doktoraturë do të synojë të realizojë **objektivat** në vijim:

- Të sigurojë njohuri të thelluara mbi rreth kërkimit në fushën e artit pamor dhe fenomeneve artistike mbi periudhën e parë që përkon me gjysmën e dytë e shek. XIX dhe deri në gjysmën e dytë të shek. XX.
- Të ofrojë instrumente dhe mekanizma kërkimi shkencorë, që do ndihmojnë në përgatitjen



e materialeve, analizave të mirëfillta kërkimore dhe shkencore, të cilat do të sugjerojnë dhe ofrojnë dokumente të cilat do të shërbejnë për të gjitha institucionet apo individët e interesuar.

- Të realizojë projektet hulumtuese brenda një mjedisi që inkurajon të gjithë ata që janë përfshirë dhe i angazhon në bashkëpunime intensive, krijuese shkencore dhe artistike;
- Të konkretizojë njohuritë shkencore me ato artistike, duke çuar drejt prodhimit të vlerave; artistike, metodave e strategjive, si edhe analizën teorike të dijeve;
- Të krijojë mundësi të zhvillimit të aftësive bazë të praktikës së kërkimit shkencor e artistik nëpërmjet të hulumtimit shkencor, krijues dhe kritik ndaj krijimtarisë shqiptare me vlera artistike dhe implementimit të kësaj praktike edhe në fusha të ndryshme sociale, kulturore, artistike, etj.

#### **4. Financimi i studimeve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në Arte Pamore**

Financimi i të gjitha veprimtarive, zhvilluar në kuadër të doktoratës do të sigurohen nga:

- a) Tarifa e studimit të programit të doktoraturës;
- b) Tarifa e regjistrimit në Konkursin e Pranimin të Studimeve në programin e doktoraturës;
- c) Fonde të siguruar nga institucione shtetërore ose organizata të ndryshme, për projektet kërkimore të studimeve të doktoraturës;
- d) Fonde të siguruar nga institucione shtetërore . ose organizata të ndryshme për kërkim in shkencor dhe/ose veprimtaritë krijuese;
- e) Fonde të siguruar, nga vetë doktorantët, pranë institucioneve shtetërore , ose organizatave të ndryshme;
- f) Vetëfinancim i doktorantit;
- g) Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta në kuadër të projektit kërkimor të doktoratës;
- h) Donacione dhe burime të tjera të ligjshme të financimit, për doktoratën;

Tarifa e studimit për çdo doktorant parashikohet në shumën **507,350 ALL**.



## 5. Kohëzgjatja e studimeve për fitimin e gradës shkencore „Doktor” në Arte Pamore

Kohëzgjatja e studimeve të doktoratës do të jetë 3-5 vite. Kriteret specifike të zhvillimit të veprimtarive, në kuadër të doktoratës, deri në 5 vite do të parashikohen në Planin e Punës, hartuar nga Udhëheqësi Shkencor dhe kandidati për fitimin e gradës shkencore "Doktor". Për çdo rast, Plani i Punës do të përmbahet afateve të parashikuara në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III për Fitimin e Gradës Shkencore "Doktor" në Arte Pamore dhe miratohet nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" në Arte Pamore. Përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të doktoratës kandidatët do të kenë detyrimin e realizimit të veprimtarive sipas përcaktimeve në tabelën e mëposhtme.

Detyrimet vjetore të kandidatit për gradën shkencore "Doktor", të detajuara në Planin e Punës, gjithsesi duhet ti përmbahen sa më poshtë:

### • Viti I

1) Në përfundim të vitit I-rë akademik, minimalisht 2 semestra, por jo më vonë se 4 semestra, nga nisja e studimeve të doktoratës, kandidati paraqet projektin kërkimor të detajuar përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme. Prezantimi realizohet me gojë dhe si rregull zgjat 15-20 minuta. Në paraqitjen e detajuar të projektit kërkimor kandidati përqendrohet në:

- a. Trajtimin e temës së kërkimit shkencor;
- b. Bibliografinë përfundimtare të përzgjedhur dhe paraqitjen e disa rasteve konkrete në lidhje me temën e kërkimit shkencor;
- c. Metodologjinë e përdorur.

Veprimtaritë e kryera në kuadër të doktoratës <sup>1</sup>	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Pjesëmarrje në Forumin e Doktoratës	Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës	Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës	Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës
Paraqitje përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme	Prezantim i detajuar i projektit kërkimor.	Prezantim i punës kërkimore dhe rezultateve të arritura.	Paraqitja e fundit e punës kërkimore.
Realizimi i të paktën tre referimeve në veprimtari shkencore (simpoziume, konferenca, kongrese). Botimi i të paktën tre artikujve shkencorë në revista Shkencore.			

<sup>1</sup> Afatet e zhvillimit të veprimtarive të paraqitura në tabelën e mësipërme janë përllogaritur për kohëzgjatjen normale prej 3 vitesh.



2. Përgjate vitit I -rë akademik, por jo me vonë se përfundimi i vitit II -të, kandidati duhet të marrë pjesë dhe të mbajë një referat, minimalisht një herë në Forumin e Doktoratës. Afati i pjesëmarrjes përgjate vitit të I rë ose II -të akademik, përcaktohet nga kandidati dhe Udhëheqësi Shkencor.

## Viti II

1. Në përfundim të vitit II-të akademik, minimalisht 4, por jo më vonë se 6 semestra nga nisja e studimeve të doktoratës, kandidati realizon paraqitjen e dytë përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëslime. Materialin e përgatitur për prezantimin e dytë hartohet në shqip, përmban 5000-6000 fjalë (pa llogaritur figura, citime, apo/ dhe tabela me numëruesin e tyre) dhe dorëzohet, pranë Njesisë Bazë Pikturë, minimalisht 15 ditë përpara datës së prezantimit. Paraqitja e dytë duhet të sigurojë informacion të detajuar rreth punës kërkimore dhe rezultateve të arritura. Njëherazi kandidati duhet të informojë Komisionin e Vlerësimit të Pjesëshëm për të gjitha veprimtaritë (artikuj të botuar, pjesëmarrje në konferenca etj..) e kryera në kuadër të studimeve të doktoratës.
2. Përgjatë vitit II-të akademik, por jo me vonë se përfundimi i vitit III-të, kandidati duhet të realizojë, minimalisht, pjesëmarrjen e dytë në Forumin e Doktoratës, ku të mbajë një referat. Afati i pjesëmarrjes, përgjatë vitit II-të, përcaktohet nga kandidati dhe Udhëheqësi Shkencor.

## Viti III

1. Në përfundim të vitit III-të akademik, minimalisht 5, por jo më vonë se 8 semestra nga nisja e studimeve të doktoratës, kandidati realizon paraqitjen e tretë përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme. Materiali i përgatitur për prezantimin e tretë, hartohet në shqip dhe përmban 5000-6000 fjalë (pa llogaritur figura, citime, dhe tabela me numeruesin e tyre) dhe dorëzohet pranë Njesisë Bazë Pikturë, minimalisht 15 ditë përpara datës së prezantimit. Paraqitja e tretë duhet të sigurojë informacion të detajuar rreth punës kërkimore dhe rezultateve të arritura në vazhdimësi. Njëherazi kandidati duhet të informojë Komisionin e Vlerësimeve të Pjesëshme për të gjitha veprimtaritë e kryera në kuadër të studimeve të doktoratës (artikuj të botuar, pjesëmarrje në konferenca etj..).
2. Përgjatë vitit të IV-ërt akademik, por jo më vonë se përfundimi i vitit V-të, kandidati duhet të realizojë minimalisht, pjesëmarrjen e tretë në Forumin e Doktoratës, ku të mbajë



një referat. Afati i pjesëmarrjes, përgjatë vitit III, ose V akademik, përcaktohet nga kandidati dhe Udhëheqësi Shkencor . Në përfundim të studimeve kandidati për doktorant do të realizojë mbrojtjen e Temës së Dizertacionit përpara Jurisë.

## **6. Lidhja me tregun e punës**

Programi i studimit të Ciklit të III-të, për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në Arte Pamore, sikurse dhe projekti shkencor janë hartuar duke pasur parasysh kërkesat aktuale të tregut të punës. Studentët, të cilët përfundojnë me sukses programin e studimit për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në Arte Pamore, do të jenë specialistë të afte për të punuar si:

1. Studiues arti pranë instituteve kërkimore;
2. Historian arti;
3. Kritik arti;
4. Menaxher – koleksionist arti
5. Pedagogë për lëndët teoriko-praktike në IAL brenda dhe jashtë vendit;

**Përgjegjës i Njesisë Bazë të Pikturës**

**Dr. Mikel TEMO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEPARTAMENTI I PIKTURËS

Nr. 164 Prot  
12

Tiranë, më 16/11/ 2022

Lënda: Përcjellje e projektit Kërkimor Shkencor për Hapjen e Programit të Ciklit të Tretë të Doktoraturës

Drejtuar: **Profesor Kastriot Çausi**  
**Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë (UART)**  
**Prof. Dr. Erald Bakalli Zv. Rektor i UART**

I nderuar z. Çausi,

Bashkëgjitur po ju dërgojmë Projektin e Kërkimit Shkencor, për hapjen e Programit të Ciklit III (Doktoraturë) në Arte Pamore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.



Me konsideratë  
**Prof. Artan Peqini**  
DEKANI I FAB-it



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEPARTAMENTI I PIKTURËS

**Projekt kërkimor shkencor për studimet e Programit të Ciklit III, në Arte Pamore  
Departamenti Pikturë, në Fakultetin e Arteve të Bukura, të Universitetit të Arteve**

Fakulteti i Arteve të Bukura, si pjesë e rëndësishme dhe integrale e Universitetit të Arteve, ka ndër të nevojën për hapjen e një programi të një cikli të tretë studimesh që do të mund të ofronte studime të thelluara tashmë në rrafshin teorik/analitik dhe krijues si pjesë plotësuese e asaj pune të madhe kryesisht me drejtim praktik (por jo vetëm) që zhvillohet në dy ciklet e para (atë Bachelor dhe Master) në fakultetin tonë. Hapja e programit të studimeve të doktoraturës është një mundësi e artë për ne si fakultet për të ecur pikërisht në këtë drejtim dhe për të përmbushur një vizion të ëndërruar prej kohësh. Aplikimi na mbush me shpresë se, më në fund, ky mision dhe vizion mund të bëhet realitet.

Teoria dhe praktika, por jo vetëm edhe krijimi, që prej gjenezës së shkencave dhe arteve, kanë ecur gjithnjë me të njëjtin hap me njëra-tjetrën. Dihet gjithashtu që raportet midis teorisë dhe praktikës, në raste specifike, mund të përmbysen në favor të njërës apo tjetrës. Dhe kjo specifike vjen pikërisht në formën e arteve të cilat, sipas proverbit gjerman “ushtrimi e bën mjeshtrin”, pavarësisht rrafshit teorik të cilin e shter domosdoshmërisht, raportin teori-praktikë e përmbysin domosdoshmërisht në favor të kësaj të fundit.

Që prej fillimit të viteve ‘90 ndryshimet që përjetoi shoqëria shqiptare u reflektuan drejtpërsëdrejti edhe në artet pamore shqiptare. Disa herë analiza dhe kritika, u gjendën në një pozicion shumë të vështirë duke u përpjekur që brenda natës të zhvishnin indoktrinimin ideologjik socialiste të para viteve ‘90 e duke tentuar, njëherazi, të ruajë profesionalizmin. Pamvarësisht, nga ndryshimet, artet pamore patë zhvillime dhe përqsaje të gjinive dhe stileve të ndaluara deri pas viteve 90’.



Në kuadër të prioriteteve të identifikuara për Studime të Thelluara në programin e doktoraturës në Arte Pamore, Departamenti përgjegjës i Pikturës në bashkëpunim me departamentet e tjera që janë: Arte të Aplikuara dhe Skulpturë, në Fakultetin e Arteve të Bukura (FAB), ka aprovuar projektin e paraqitur nga Dr. Ermir Hoxha: *“Arti shqiptar nga mesi i shek. XIX deri në fund të shek. XX. Zhvillime historike, personalitete dhe fenomene artistike”*.

**Projekti kërkimor “Arti shqiptar nga mesi i shek. XIX deri në fund të shek. XX. Zhvillime historike, personalitete dhe fenomene artistike”.**

#### **Qëllimi i projektit:**

Projekti i propozuar i përgjigjet një prej kërkesave dhe sfidave emergjente me të cilat përballet sot Departamenti i Pikturës, i Arteve të Aplikuara dhe Skulpturës dhe thellimit në një prej fushave ndër më të rëndësishme për studime të thelluara në artin pamor shqiptar, me përqasje e metodologji bashkohore, të cilat do të nxjerrin vlerat shkencore mbi personalitete të artit pamor shqiptar që i dhanë artit vendas identitet për gjatë gjithë shek. XX, do të studiojnë analiza fenomenologjike mbi periudha të caktuara historike.

#### **Objektivat e projektit:**

**Objektivi specifik 1: Të zotërojnë njohuri të thelluara rreth kërkimit në fushën e artit pamor dhe fenomeneve artistike mbi periudhën e parë që përkon me gjysmën e dytë e shek. XIX.**

Njohja dhe analizimi i teorive, koncepteve dhe mjeteve kryesore që lidhen me zhvillimin e artit pamor shqiptar në këtë periudhë janë edhe gjetjet mbi disa fenomen të reja që shfaqen e realitetin shqiptar të mesit të shek. XIX, siç janë piktura realiste dhe fotografia. Të dy këto medime, ndërtuar nga pak protagonistë dhe në të njëjtat hapsira realizuan në pak kohë themelimin e artit realist në Shqipëri dhe nisjen e një tradite që vazhdon ende sot.

- Studim mbi njohjen me realizimin romantik në realitetin shqiptar në shek. XIX.
- Studim mbi zhvillimin e pikturës realiste në Artin shqiptar, mes temës religjioze dhe asaj laike.





- Studim mbi historikun e personaliteteve / piktorët e parë realistë në realitetin oriental të Shqipërisë në shek. XIX.
- Studim mbi zhvillimin e Shqipërinë dhe shqiptarët në optikën e artistëve Perëndimor në shek. XIX –XX.
- Studim mbi zhvillimin e fotografisë si medium i ri në realitetin oriental shqiptar në shek. XIX.
- Studim mbi zhvillimin e dialogut mes medimeve artistike në shek. XIX.
- Studim mbi kuptimin e funksionit dhe kuptimin e artistit në kapërcim të shek. XIX-XX.

**Objektivi specifik 2: Të zotërojnë njohuri të thelluara rreth kërkimit në fushën e artit pamor mbi periudhën e dytë: Gjysma e parë e shek. XX.**

Kryerja e analizave krahasimore duke evidentuar protagonistët e artit shqiptar në gjysmën e dytë të shek XX, si dhe studimin e fenomenit të Realizmit socialist në gjithë format dhe analizat mbi piktorët e parë profesionist vendas, shtrirë në harkun kohor të viteve '20-'40, apo dhe themelimit të skulpturës monumentale publike, i institucioneve të para arsimore e kulturore artistike.

- Studim rreth gjetjeve për piktorët e parë profesionist në realitetin shqiptar të Pavarësisë.
- Studim mbi zhvillimin e institucioneve të e para artistike në vend, shoqatave, shkollave dhe rëndësia e tyre.
- Studim rreth gjetjeve për piktorët skulpturën monumentale në realitetin monarkik shqiptar.
- Studim rreth gjetjeve për studentët shqiptarë në Akademitë Perëndimore, shek. XIX –XX.
- Studim mbi zhvillimin e peizazhit si optikë tjetër e njohjes së realitetit shqiptar në pikturën e viteve '30-'40.
- Studim mbi zhvillimin e figurës së njeriut në pikturën e viteve '30-'40, mes kërkimit akademik dhe atij formal.
- Studim mbi zhvillimin e fotografisë në periudhën e saj të artë, gjysma e parë e shek. XX dhe marrëdhënia e saj me artet e tjera.
- Studim mbi zhvillimin e fotografisë shqiptare dhe familjet e mëdha të kësaj gjinie, impakti i tyre në ndërtimin e memories vizive të kombit.



- Studim mbi zhvillimin e studiove fotografike, mes traditës dhe ritualit.

**Objektivi specifik 3: Të zotërojnë njohuri të thelluara rreth kërkimit në fushën e artit pamor mbi periudhën e tretë: Gjysma e dytë e shek. XX.**

Kryerja dhe humultimi i mbi artin totalitar dhe përthyerja e tij në realitetin shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore. Përveç kësaj mbetet primare thellmi i studimeve mbi protagonistët e artit shqiptar në gjysmën e dytë të shek XX, si dhe studimi i fenomenit të Realizmit socialist në gjithë format e tij. Një hapsirë e veçantë i rezervohet periudhës së fund shek XX, kur në realitetin shqiptar nisin tendencat e para të një krijimtari tërësisht të lirë nga imponimi tematik e strukturor nga sistemi monopartiaki periudhës së komunizmit.

- Studim mbi zhvillimin e Artit Shqiptar në periudhën e Pasluftës së II Botërore dhe marrëdhënia e shtetit totalitar me artin.
- Studim mbi instalimin e Realizmit Socialist në Shqipëri, temat dhe protagonistët.
- Studim mbi zhvillimin e revolucionit kulturor dhe ndikimin e tij në artin shqiptar.
- Studim mbi zhvillimin e imazhit modern të fotografisë me ngjyra dhe fotografia propagandistike në vitet '60.
- Studim mbi zhvillimin dhe ndikimet e zhvillimeve politike në artin vendas në vitet '50-'80, marrëdhënia e artisti me shtetin totalitar.
- Studim mbi zhvillimin e pikturës në artin vendas në vitet '60-80, protagonistët dhe temat.
- Studim mbi zhvillimin e skulpturës gjatë Realizmit socialist dhe kërkimet personale jashtë imponimit tematike e formal.
- Studim mbi zhvillimin e arteve të aplikura në realitetin artistik shqiptar në vitet '70- '80.
- Studim mbi protagonistët e themelimit të skulpturës monumentale në periudhën e komunizmit në Shqipëri.
- Studim mbi studentët shqiptar në vendet e Lindjes, eksperiencat dhe ndërtimin e personaliteteve artistike të tyre.
- Studim mbi themelimin dhe zhvillimin e institucioneve të para artistike në vitet '60.
- Studim mbi zhvillimin, liberalizimin dhe tendencat moderne në artin shqiptar.
- Studim mbi zhvillimin modernitetit në realitetin artistik shqiptar në shek. XX.
- Studim mbi zhvillimin e realizmit socialist në stilin shqiptar pas Plenumit të IV.
- Studim mbi zhvillimin e tendencave moderne në artin shqiptar në fundin e viteve '80.



- Studim mbi ndryshimet estetike dhe tematike në artin shqiptar në vitet '90, mediumet e reja dhe institucionet e reja artistike.

Studim mbi zhvillimin e Artit bashkohor shqiptar, mes traditës dhe medimeve të reja teknologjike.

### **Përshkrimi i projektit**

Projekti kërkimor i orientuar i studimeve doktrale jo pa qëllim do të merret me këtë periudhë, pasi kërkon pikëpamje plotësimin e mangësive të informacionit dhe studimeve për këtë periudhë, por edhe intensifikimin e dialogut studimor me institucionet e ngjashme, si në nivel konferencash ashtu dhe botimesh.

Tre dekadat e fundit studimet në fushën albanologjike kanë pasur një dinamikë të vetën. Ato konsistojnë në ndërthurjen e projekteve kërkimore të ndërmarra nga disa institucione njëkohësisht, projekte ku disa prej tyre janë zhvilluar në institucione brenda vendit dhe një pjesë janë katedra të albanologjisë të stacionuara kryesisht në vendet Perëndimore. E gjithë kjo është përcaktuar kryesisht nga zhvillimet politike të pas viteve '90, kur metodologjia, fusha kërkimore dhe botimet me temë mbi historinë, artin dhe kulturën shqiptare u shumëfishuan. Kështu studiuesit e huaj, ato vendas të shkolluar brenda apo jashtë vendit, sidomos pas viteve 2000 nisën një fazë të re të studimeve të orientuara me temë shqiptare. Periudha specifike si Prehistoria, Antikiteti, ajo Mesjetare Bizantine apo Post Bizantine, me gjithë nënproduktet e veta tipike, iu nënshtruan rishikimit, bazuar në materialet e reja të gjendura në arkiva, apo dhe rikorigjimit nga imponimi i sistemit të kaluar si në përjashtë ashtu dhe në terminologji.

Projekti kërkimor i orientuar i studimeve doktrale jo pa qëllim do të merret me këtë periudhë, pasi kërkon pikëpamje plotësimin e mangësive të informacionit dhe studimeve për këtë periudhë, por edhe intensifikimin e dialogut studimor me institucionet e ngjashme, si në nivel konferencash ashtu dhe botimesh.

Përveç kësaj mungesa e literaturës së shkruar pas viteve '90, ka sjellë domosdoshmërinë dhe kërkesën e një analize të mirëfilltë historike të kohës dhe fenomenit. Kjo domosdoshmëri bëhet edhe më e dukshme nga prezenca reale e një morie burimesh studimore. E përqëndruar në personalitete ende gjallë, mure galerish, biblioteka, arkiva, koleksione private a shtetërore, aty do të bibilotekohet memoria dhe puna gjysmë shekullore e një vendi, çka përbën një detyrim moral e profesional, sidomos për brezin e ri, i cili me optikë tashmë ndryshe, me mjete e qëllime të reja, duhet të zbërthejë fenomenin e arti shqiptar përgjatë gjithë shek. XX,



zbatuar në truallin e etërve. Për ta kjo sfidë vlen mundin, pasi e gjithë kjo trashëgimi, në botëkuptimin e vet është e kaluara, dhe si e tillë e domosdoshme për të kuptuar të tashmen. Në një kuptim tjetër, për çdo studiues të ri nevoja për të “përditësuar” studimet e kohës, lind si një detyrim moral e profesional, pasi përtej çdo justifikimi, gjithsecili prej nesh duhet të japë kontributin e vet në plotësimin e mozaikut të pafund të zhvillimit të shkencës së historisë dhe estetikës së artit pamor.

Projekti kërkimor “*Arti shqiptar nga mesi i shek. XIX deri në fund të shek. XX. zhvillime historike, personalitete dhe fenomene artistike*” ka si qëllim:

Të zhvillojë aftësitë artistike, të gjenerojë njohuri të reja dhe të avancojë në mënyrë të thelluar kërkimet në fushën e arteve pamore, për plotësimin e nevojave të kësaj fushe të krijimtarisë artistike shqiptare me ekspertë, studiues arti dhe kritikë arti, me praktika krijuese bashkëkohore artistike, si dhe staf akademik e mësimdhënës, duke u thelluar në studimin e fenomeneve artistike bashkëkohore shqiptare, krijuesve dhe lidhjen e tyre në një kontekst global me zhvillimet artistike të kohës.

Për të përmbushur këtë qëllim, ky projekt do të synojë të realizojë **objektivat** në vijim:

- Të sigurojë njohuri të thelluara mbi rreth kërkimit në fushën e artit pamor dhe fenomeneve artistike mbi periudhën e parë që përkon me gjysmën e dytë e shek. XIX dhe deri në gjysmën e dytë të shek. XX.
- Të ofrojë instrumente dhe mekanizma kërkimi shkencorë, që do ndihmojnë në përgatitjen e materialeve, analizave të mirëfillta kërkimore dhe shkencore, të cilat do të sugjerojnë dhe ofrojnë dokumente të cilat do të shërbejnë për të gjitha institucionet apo individët e interesuar.
- Të realizojë projektet hulumtuese brenda një mjedisi që inkurajon të gjithë ata që janë përfshirë dhe i angazhon në bashkëpunime intensive, krijuese shkencore dhe artistike;
- Të konkretizojë njohuritë shkencore me ato artistike, duke çuar drejt prodhimit të vlerave; artistike, metodave e strategjive, si edhe analizën teorike të dijeve;
- Të krijojë mundësi të zhvillimit të aftësive bazë të praktikës së kërkimit shkencor e artistik nëpërmjet të hulumtimit shkencor, krijues dhe kritik ndaj krijimtarisë shqiptare me vlera artistike dhe implementimit të kësaj praktike edhe në fusha të ndryshme sociale, kulturore, artistike, etj.



Në drejtim të kontributit teorik, projekti do të synojë të krijojë një bazament të sistemuar dhe cilësor të literaturës, dijes bashkëkohore dhe autorëve më në zë dhe të spikatur të fushës së artit pamor çka do të përbëjë një premisë të sigurt për sigurimin e argumenteve të forta dhe të mirëmbështetura për analizat, studimet dhe kërkimet që synohen të ndërmerren gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit, në kuadër të ngritjen e plotësimin e kapaciteteve institucionale, në fushën e arteve në Shqipëri.

Ndërkohë, në këndvështrimin praktik, projekti do të synojë përgatitjen e materialeve, analizave të mirëfillta kërkimore dhe shkencore, vlera shkencore, historike, krijuese, analizuose, krahasuese dhe artistike mbi artet pamore shqiptare e më gjerë në rajon si në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, tek Arbëreshët e më tej, me artet pamore në rrafsh ballkanik dhe europian. Produkti i këtyre materialeve teorike të botuara në formë disertacioni apo monografish do të shërbejnë si:

- kontribut teorik si vlerë e shtuar në të gjithë historinë e zhvillimit të artit pamor shqiptar,
- bazë teorike në përmirësimin e kurrikulës së programeve Bachelor dhe Master për studentët e arteve,
- material teorik referues për studiuesit e njohësit e historisë së artit shqiptar,
- material promovues për personalitete të arteve pamore shqiptare, deri tani jo shumë të përhapura,
- material teorik ndihmues dhe referues për insitucionet kërkimore e shkencore që punojnë në fushën e arteve,
- material shkencor, artistik e historik për një publik artdashës, duke plotësuar njohuritë e tij në këtë fushë të arteve,
- material referues për studiuesit e huaj të së njëjtës fushë dhe pikë referimi krahasuese në analizat e tyre teorike e krahasuese të zhvillimit të historisë së arteve pamore në Ballkan dhe Europë.

### **Realizimi projektit:**

Projekti do të realizohet nga profesori i Departamentit Pikturë të FAB. Grupi drejtues i projektit do të përcaktojë qartë temat hulumtuese e krijuese të analizës së zhvillimit të shkollës së arteve pamore shqiptare dhe lidhjen e saj me zhvillimin e arteve pamore shqiptare përgjatë gjysmës së dytë të shek. 19 dhe përgjat shekullit të 20 - të. Drejtuesit e projektit duke përcaktuar tematikat hulumtuese që realizojnë objektivat dhe qëllimin e projektit dhe do të



synojnë që realizimi projektit kërkimor e krijues të prodhojë një material të pasur teorik për publikun, studiuesit profesionistët aktualë dhe të ardhshëm të arteve pamore shqiptare dhe mbarëshqiptare dhe gjithë grupet e interesit që janë të ndjeshëm dhe të interesuar në lidhje me historinë dhe zhvillimin e arteve pamore shqiptare.

Realizimi i projektit do të ndërmerret me përfshirjen e disa studentëve doktorantë. Ata nëpërmjet programit të studimit të doktoraturës do të realizojnë kërkimin shkencor e krijues nën udhëheqjen e profesorit të Fakultetit të Arteve të Bukura. Puna e tyre kërkimore do të fokusohet në tematikat individuale për secilin student të doktoraturës, sipas nënfushave të profileve të tyre dhe në kompleks rezultatet e elaborimit të tematikave të studimit do të prodhojnë një material që do të përmbushë objektivat e secilës tematikë krijuese e kërkimore. Grupi i studentëve doktorantë duhet të plotësojë disa kriteret të përcaktuara në kriteret hyrëse të shpallura nga departamenti i Pikturë, Arteve të Aplikuara dhe Skulpturës. Studentët pjesëmarrës në projekt do të jenë sigurisht studentët fitues të programit të doktoraturës. Gjatësia e projektit do të jetë nga tri deri në pesë vite dhe studentët doktorantë do të jenë të atashuar në këtë proces pranë departamentit Pikturë, duke kryer hulumtimin e tyre teorik e krijues me fokus tematikat që lidhen me arteve pamore shqiptare përgjatë gjysmës së dytë të shek. 19 dhe përgjatë shekullit të 20 -të.

### III. Metodologjia e projektit

Arti shqiptar në përqasjen e vet sinkretike, përgjatë gjithë shek. XX njihet përgjithësisht si një krijimtari me përqasje realiste, edhe pse në totalitetin e vet ai ka qindra sfumatura, e shpesh dhe periudha ku ata, artistët, zhvilluan estetikën e tyre herë larg e herë tejet afër një produkti politik.

Projekti kërkimor me titull "*Arti shqiptar nga mesi i shek. XIX deri në fund të shek. XX. Zhvillime historike, personalitete dhe fenomene artistike*" mundohet ti ofrojë kandidatëve të interesuar një aparat tematik, çështjesh e objektesh kërkimore ndaj të cilave ata mund të përqasen në një varietet të madh metodash kërkimore. Kjo bëhet e mundur duke pasur parasysh se një pjesë e tyre mund të vijnë nga ndërtime akademike të ndryshme, e si të tillë mund të jenë formuar me aparate të ndryshëm kërkimor ndaj një çështje studimore.

Projekti kërkimor ndjek një rrugë orientuese historike e fenomenologjike të ndarë sipas periudhave historike. Ajo cek në mënyrë konstante zhvillimet artistike përgjatë dekadave duke i shpjeguar ato nëpërmjet medimeve të pikturës, skulpturës, arkitekturës dhe



fotografisë. Si çdo program historie arti tradicionale, ajo ndalet në autorët e veprat më të rëndësishme, si për kohën kur u realizuan dhe për jehonën që ato trasmetuan në dekadat e mëpasshme. Pra metoda e parë e cila ofrohet si mundësi përfaqëse studimore është **Metoda Historike**, e cila pasurohet nga ajo **analitiko-deskriptive**. Kjo duke qenë dhe metoda më e përhapur në shkollën vendase ende sot propozohet si formati më i përshtatshëm për tu përdorur. Kjo përforcohet edhe nga hapsira e madhe e pa trajtuar e shumë personaliteteve vendas, aq sa dhe të periudhave të caktuara në artin vendas, të cilat para se të kridhen në formate metodologjik të tjerë e shohim të arsyeshme të konsumohen fillimisht si fenomene historike, e mëpas të propozohen pse jo në metoda më bashkohore analitike.

Metoda e dytë e propozuar është **Metoda Interpretative Fenomenologjike** e cila mund të shtrihet horizontalisht e vertikalisht mbi artin vendas si metodë, në kontekst historik e estetik. Më e përshtatshme kjo metodë është në periudhën e tretë që përkon me atë të zhvilluan pas gjysmës së dytë të shek. XX, njohur përgjithësisht si periudha e Realizmit socialist. Kjo ndodh pasi temat, standardet, stili dhe stereotipat që e përshkuan këtë fenomen global për më se gjysmë shekulli, kërkojnë një analizë kuptimore fenomenologjike gjithëpërfshirëse, duke e propozuar artin shqiptar mes viteve të sipërpërmendura si një nënprodukt i një fenomeni “nënë”, shumë më të gjerë, por tipik për artin totalitar të shekullit të XX. I ndërgjegjshëm që ai i shtrin rrënjët thellë në shekuj, në vizionin a platformën e çdo lideri a monarku sa në perëndim aq dhe në lindje të kontinentit evropian, fenomeni i Artit totalitar është shprehje e vetëdijshme e çdo udhëheqësi për të vënë në shërbim të pushtetit personal çdo element për të ngritur të ashtuquajturin kult të individit. Si i tillë në këtë rast metoda interpretative fenomenologjike shihet si më favorizuesja për një përfaqëse sa më cilësore mbi produktin dhe temat që e shoqërojnë atë. Bashkë me tematikat e shumta brenda sojit, studimet mund të zgjerohenedhe në përfaqëseje diakronike të fenomenit duke e shoqëron atë në gjithë shtrirjen e tij. Një analizë sa sinkretike aq dhe diakronike, duket më se funksionale për një përkufizim gjithëpërfshirës mbi fenomenin, apo analiza specifike mbi raportin mes shtetit dhe artistit të cilat meritojnë një hapësirë të dedikuar.

Metoda fenomenologjike mund të shoqërohet fare mirë dhe nga **Metoda Krahasimore**, e cila pikërisht në gjykimin e temave të zhvilluara në këtë periudhë, të cilat erdhën si nënprodukt i imponuar nga një realitet politik botëror, mund të japë rezultate me një dinamikë krejt tjetër. Kështu tema si ajo e Puntorit, Kultit të Individit, Ushtri-Popull, Emancipimi i gruas, Parajsë socialiste etj., mund të analizohen në mënyrë edhe më të efektshme nga kombinimi i këtyre



dy metodave të fundit. Kjo pasi ato nuk u zhvilluan të pavarura në realitetin vendas, por u importuan nga Vendet e Lindjes nga një politikë shtetërore e mirë orientuar, për tu përshtatur e modifikuar pastaj në atë shqiptar.

Çdo kandidat doktorand mund të propozojë zhvillimin e një teme krahasimore mes këtyre temave nga realiteti vendas në ato të vendeve të tjera, gjithnjë duke mbetur të kujdesshëm që të mbeten ato të mbeten tema në mikro, pra brenda mundësive reale të mbledhjes së informacionit.

### **Qëndrueshmëria dhe dobia e projekti:**

Përfundimi i projektit do të realizohet me prodhimin e disa materialeve teorike me vlera shkencore, krijuese, krahasuese, artistike dhe historike mbi zhvillimin e arteve pamore shqiptare dhe evoluimin e saj përmes etapave të zhvillimit të historisë së arteve pamore shqiptar e më gjerë duke e parë këtë lidhje edhe në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi e më tej me teatrin ballkanik e evropian. Produkti i materialeve teorike të botuara në formë disertacioni apo monografie do të ndihmojë publikun dhe forcat krijuese artistike shqiptare e më gjerë në drejtimet si më poshtë:

- Së pari do të jetë një kontribut teorik për një hulumtim historik mbi kritere shkencore i lidhjes së arteve pamore shqiptare me zhvillimin e artit pamor shqiptar në tërësi gjysmës së shekullit 19 dhe të 20-të.
- Së dyti do të shërbejë si bazë teorike në kurrikulën e programit të studimit për studentët e Fakultetit të Arteve të Bukura në të gjitha programet e studimeve.
- Së treti do të shërbejë si një material teorik referues për studiuesit e njohësit e historisë dhe zhvillimit të arteve pamore shqiptare.
- Së katërti do të shërbejë për promovimin e kontributit të shumë figurave të artit pamor shqiptar, deri tani jo shumë të elaboruara.
- Së pesti do të shërbejë publikut artdashës shqiptar si një material shkencor, artistik e historik për të plotësuar njohuritë e tij në drejtim të etapave të zhvillimit të artit pamor shqiptar përgjatë gjysmës së shekullit 19 dhe të 20-të.
- Së gjashti do të shërbejë studiuesve të huaj të fushës si pikë referimi krahasuese mbi analizat e tyre për zhvillimin e historisë së artit pamor në Ballkan dhe Evropë, duke u përdorur si burim shkencor serioz dhe me besueshmëri të lartë.





- Së shtati do të plotësojë informacionin mbi historinë e artit pamor kombëtar shqiptar duke shërbyer si material burimor shkencor për t'iu referuar në studimet e ardhshme si për studiuesit shqiptar dhe për ata evropian.

Ky projekt kërkimor e krijues në ndihmë të programit të doktoraturës, do të shërbejë edhe si një model për të mundësuar vendosjen e një tradite kërkimore në programet e studimit të doktoraturës në fushën tonë, ku nëpërmjet realizimit të projekteve kërkimore të zhvillohet edhe kualifikimi i një mase të re të studiuesve shqiptarë të artit.

### **Outputi projektit**

Realizimi i projektit do të prodhojë:

- Disa monografi me vlera shkencore e krijuese mbi artet pamore shqiptare dhe zhvillimin e tyre në tërësi.
- Formimin e kapaciteteve shkencore si specialistë të kualifikuar në fushën arteve pamore dhe historisë së artit pamor shqiptar.
- Krijimin e një baze teorike shkencore e krijuese që do të mund të përdoret si burim bibliografik me besueshmëri të lartë në studimet krahasuese të fushës nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj.
- Rritjen e aktivitetit shkencor e krijues të profesoratit të departamenteve në IAL shqiptare në fushën e kërkimit shkencor dhe aktivitetit krijues e artistik, aq deficitar në botën universitare shqiptare.

**Përgjegjësi i Njesisë Bazë, Pikturë**

**Dr. Mikel TEMO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

DEPARTAMENTI PIKTURË, ARTE TË APLIKUARA DHE SKULPTURË

PROJEKT PROPOZIM PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DOKTORATURË  
“NË ARTET PAMORE”

<b>Institucioni IAL</b>  Universiteti i Arteve Tiranë (UART)	<b>Aplikimi</b>  Program i ri studimi i ciklit të tretë Doktoraturë.
<b>3. Emërtimi programit të propozuar për hapje:</b> DOKTORATURË “NË ARTET PAMORE”.	
<b>4. Semestri dhe viti akademik i hapjes</b> Semestri parë në vitin akademik 2023 – 2024.	
5. Të dhëna për aktin e hapjes /akreditimit të IAL dhe ose njësisë kryesore që ofron programin: VKM nr. 234 datë 23. 03. 2011 ”Për krijimin e Universitetit të Arteve” Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 68 datë 21.09.2017, “Universiteti i Arteve” akreditohet në nivel institucional”	
6. Vendimi miratimit nga senati akademik  _____ Vendimi miratimit nga Bordi Administrimit  _____	
7. Nëse është një program i përbashkët studimi identifikoj IAL e tjera bashkëpunuese dhe cito aktin e hapjes e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marëveshjen Specifike. <i>(Ky program do të jetë për të gjitha specialitetet e Fakultetit të Arteve të Bukura: pikturë, skulpturë, tekstil- modë, qeramikë, grafikë, multimedia, fotografi.)</i>	



#### 8. **Programi Ofrohet:**

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Artet Pamore implementohet si një program i përbashkët midis departamenteve, ku departamenti “Pikturë” i cili drejton dhe është departament përgjegjës për profilin/et që burojnë si më poshtë vijon:

Profili: **1. Pikturë**; 1. Arte të Aplikuara; 3. Skulpturë.

Departamenti i Pikturë

Fakulteti i Arteve të Bukura (FAB)

Kampusi / godina: FAB, Godina E

#### 9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit

Dr. Mikel Temo

Përgjegjës **Njësia Bazë Pikturë** dhe Arte të Aplikuara dhe Skulpturë ,

Fakulteti i Arteve të Bukura.

Tel : ++

E –mail :

#### 10. ***Deklarata e titullarit të IAL për plotësimin e standarteve akademike e infrastrukurore të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.***

Unë, i nënshkruari Kastriot Çausi, në cilësinë e Rektorit të Universitetit të Arteve, Tiranë, deklaroj se marr përsipër plotësimin e standardeve akademike sipas përcaktimeve përkatëse në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Propozimi i paraqitur i departamentit të Arteve të Aplikuara, Pikturës dhe Skulpturës pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, pranë UART për hapjen e programit të Ciklit të Tretë doktoraturë në Artet Pamore, e cila përbën një risi në ecurinë e mëtejshme të avancimit dhe vijueshmërisë të cikleve të studimit në Universitetin e Arteve. Ky program është një domosdoshmëri për zhvillimin profesional të studentëve që do e ndjekin, dhe jo vetëm si artistë por edhe si studiues, duke zgjeruar aftësitë artistike dhe krijeseme njohuri të reja dhe duke zbatuar metoda artistike inovative në aktivitetin e tyre specifik profesional në fushën e artit.

Programi do të realizohet nga stafi akademik i kategorisë profesor, me eksperiencë në kërkimin shkencor dhe artistik, si dhe me një infrastrukturë efektive që siguron edhe



dimensionin ndërkombëtar me bashkëpunime, partneritete, rrjete etj. Realizimi i kërkimit shkencor e artistik të këtij programi doktorature në fushën e artit do të ndihmojë edhe për avancimin në disipinën e përzgjedhur duke zgjeruar kufijtë dhe duke krijuar marrëdhënie të reja ndërdisiplinore me insitucionet analoge në rajonin e Ballkanit dhe më tej.

Programi kërkimor realizohet nga një staf akademik i kategorisë profesor, me ekseperiencë në kërkimin shkencor dhe artistic, me profil aktiv në kërkimin artistik dhe shkencor, si dhe me një infrastukturë efektive që siguron edhe dimensionin ndërkombëtar dhe bashkëpunime, partneritete, rrjete edhe të tjera. Realizimi i kërkimit shkencor dhe artistik të këtij programi doktorature do të ndihmojë edhe për avancimin në disipinën e përzgjedhur, duke zgjeruar kufijtë dhe duke krijuar marrëdhënie të reja ndërdisiplinore me insitucionet analoge në rajonin e Ballkanit dhe më tej.

Si përfundim unë mbështes Programin Kërkimor të UAR, ku pjesë e tij janë Projektet Kërkimore të FAB, si pjesë e Programit të Ciklit të III, Doktoraturë në Arte Pamore.

Departamenti ka një personel akademik me reputacion dhe kontribute kombëtare e më gjerë në fushën e Kërkimit në Arte Pamore, me veprimtari të pasur akademike e profesionale, me botime cilësore dhe që përdoren në mbarë hapësirën mbarëshqiptare, dhe po ashtu zotëron hapësirat e nevojshme mbështetëse e logjistike për zhvillimin normal të Ciklit të Tretë të studimeve.

Firma (Emër/Mbiemër) e titullarit të insitucionit dhe vula e insitucionit.

Prof. Kastriot Çausi / Rektor , UNIVERSITETI I ARTEVE

Firma ( \_\_\_\_\_ )

Vula ( \_\_\_\_\_ )



## **PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT**

### **PËRSHKRIMI PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE DOKTORATURA**

Doktoratura në Programin e Studimit në Fakultetin e Arteve të Bukura, pranë Universitetin e Arteve është një cikël i tretë i studimeve pasuniversitare dhe kërkimeve shkencore të kombinuara, akademike dhe artistike të specialiteteve pikturë, grafikë, tekstil mode, multimedia, skulpturë, qeramikë, fotografi dhe histori arti.


Ajo i siguron pjesëmarrësit me një mundësi për të realizuar projektet e tyre individuale hulumtuese brenda një ambienti që inkurajon të gjithë ata që janë përfshirë dhe që do të angazhohen në bashkëpunime intensive kreative shkencore dhe artistike.

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Artet Pamore synon ndërthurjen e artit dhe të dijes si dhe të produktivitetit të vlerave artistike dhe metodave e strategjive në aspektin e produksionit artistik dhe analizën teorike të dijeve.

Metodat dhe strategjitë do të përbëjnë praktikën shkencore të përfshira për të fituar titullin, i cili është konceptuar për t'u ndërthurur në mënyra të shumta në fushat sociale, kulturore, artistike, etj.

Ato veçanërisht vlejné për reflektimin kritik mbi krijimtarinë me vlera artistike, e cila do të bëhet edhe një metodë dhe objekt i hulumtimit shkencor.

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë vjen si një nevojë e kahershme e plotësimit të ciklit edukativ akademik në fushën e arteve pamore në Shqipëri. Prej shumë vitesh tashmë, kjo nevojë ka qenë e pranishme, e lidhur ngushtë me mungesën e kërkimit shkencor, kritikës, ekspertizës profesionale



dhe, në përgjithësi, rritjes së nivelit akademik dhe shkencor të stafit mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Bukura.

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Arte Pamore është krijuar për të fuqizuar akademikët dhe profesionistët e angazhuar në fushat e kërkimeve shkencore akademike, të përqendruar në çështjet që lidhen me lëmin e: arteve të aplikuara, pikturës dhe skulpturës. Ky program studimi kërkon të sigurojë studime të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e fenomeneve artistike në Artet Pamore, për t'i përgatitur studentët për avancim akademik, kërkimor, si dhe karrierë të avancuar profesionale.

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Arte Pamore vjen si një nevojë e domosdoshme e plotësisht të ciklit edukativ akademik në fushën e arteve pamore në Shqipëri. Prej shumë vitesh tashmë, kjo nevojë ka qenë e pranishme, e lidhur ngushtë me mungesën e kërkimit shkencor, të kritikës, të ekspertizës profesionale dhe, në përgjithësi, të rritjes së nivelit akademik dhe shkencor të stafit mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Bukura.

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Arte Pamore në Fakultetin e Arteve të Bukura pranë Universitetit të Arteve do të krijojë mundësitë, për të drejtuar teorikisht, dhe shndërrimin dhe rolin e arteve pamore në një "formë të dijes" duke u bërë fokusi i një konteksi kërkimor me orientim ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, kushtet e nevojshme për vetënjohur krijimitarë artistike, të përbëjnë një objekt të hulumtimit themelor të kombinuar ndërmjet veprimtarive akademike dhe artistike.

Programi i Doktoratës i cili mbështetet në *Kërkime Artistike* (Doktor në Artet Pamore) në FAB në Universitetin e Arteve paraqet një program studimi pasuniversitar në fushën e artit, në të cilin gjenerohet kërkimi i pavarur artistik për të kontribuar në zhvillimin dhe vlerësimin e arteve.

Këto studime përqëndrohen në punën artistike që vlerësohet si bazë e krijimit të njohurive. Programi i Doktoratës për *Kërkime Artistike* drejtohet nga tema dhe projektet e kërkimit artistik. Kontestimi dhe reflektimi i metodave specifike dhe proceseve të krijimit të projektit artistik paraqesin një pjesë të rëndësishme të përfshirë në punën kërkimore.

Kështu,

- a) Programi do të mbështeten në hulumtimin dhe në kuptimin e formimit gjithëpërfshirës të njohurive të fituara të cilat përcaktojnë rezultatet e arritura të studentit.



- b) Programi i doktoratës do të përbëhet nga lëndë dhe një temë në formën e një teze kërkimore artistike.
- c) Teza në formën e një projekti kërkimor artistik që do të krijohet, përkatësisht një tezë në formën e një numri projektsh artistike të lidhura me njëra-tjetrën përsa i përket çështjes së kërkimit (kompleksi artistik i punës, grupeve të punës).
- d) Rezultati i hulumtimit duhet të dokumentohet në një mënyrë të përshtatshme do të kontekstualizohet dhe reflektohet.

## **A. Të dhëna mbi programin e Studimit**

### **1. Përshkrimi përgjithshëm i programit, misioni, qëllimi dhe objektivat**

Programi i Ciklit të Tretë të studimit në doktoraturë në fushën e arteve pamore mundëson studentët e këtij programi të japin një kontribut kërkimor e krijues origjinal në fushën e arteve pamore.

Ky program synon të zhvillojë aftësitë artistike, të gjenerojë kërkime inovative dhe të avancojë kërkimet në fushën e arteve pamore. Ai mundëson që studentët e regjistruar në këtë program të zhvillohen profesionalisht si artistë dhe studiues, duke iu dhënë mundësinë çdo doktoranti të fitojë *kompetenca artistike* dhe *aftësi krijuese* mbështetur njohuri të reja si dhe zbatimin e metodave artistike innovative në aktivitetin profesional në fushën e artit.

Ky program studimi i Ciklit të Tretë Doktorature në fushën e arteve pamore ka mbajtur parasysh parimet e përgjithshme për edukimin doktoral, të sjella përmes Rekomandimeve të Salzburgut II dhe në Parimet mbi Trajnimin Inovativ të Doktoraturës.

Teza e doktoraturës në këtë program studimi përfshin zhvillimin nga kandidati të një projekti origjinal dhe konkret të kërkimit shkencor dhe artistik. Ky program inicon nga studentët përdorimin e e metodave krahasuese shkencore dhe teknikave artistike, duke prodhuar një kontribut origjinal me publikimin e produkteve të reja me karakter shkencor e artistik brenda fushës hulumtuese të programit. Hartimi programit doktoraturës fokusohet tek lidhja mes arteve pamore në veçanti dhe historisë së zhvillimit të arteve pamore në Shqipëri bazuar në një seri tematikash me natyrë kërkimore dhe artistike dhe që dokumentojnë procesin e kërkimit në këtë program doktorature. Elementë të nënkuptuar në praktikën e kërkimit shkencor dhe artistik në këtë program janë edhe shikimi në rrafshin krahasues me ndërdisiplinarizimin dhe interkulturalizimin me programet e doktoraturës në institucionet homologe në fushën e arteve në rajon dhe Europë.



Fokusi i programit Doktoraturës bazohet tek puna kërkimore e krijuese e studentëve, mbi analizat teorike e praktike të zhvillimit të arteve pamore shqiptare. Programi studimit që ka në thelb punën kërkimore e krijuese të studentëve nën udhëheqjen e stafit akademik të departamentit dhe realizohet nëpërmjet ndërmarjes së analizave shkencore, historike, krahasuese dhe interpretative nëpërmjet hartimit të punimeve shkencore e krijuese që lidhen me rolin që kanë luajtur karakteristikat e zhvillimit të shkollës shqiptare të artit pamor përgjatë etapave të ndryshme të historisë.

Analiza shkencore e krahasuese e kësaj lidhje që përshkon boshtin e këtij programi doktorature në fushën e arteve pamore fokusohet në analizën e zhvillimit të interpretimit përgjatë ecurisë edhe në trevat shqipfolëse në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, por edhe më gjërë në rajon si dhe Europë.

Mjedisi shkencor dhe artistik për realizimin e këtij programi doktorature përfshin një mjedis me standarte kërkimore e cilësore nga pikpamja artistike. Mjedisi siguron avancimin më të mirë të mundshëm disiplinor të punës krijuese e artistike.

Programi kërkimor do të realizohet nga stafi akademik i kategorisë profesor, me eksperiencë në kërkimin shkencor dhe artistik, me profil cilësor krijues dhe në kërkimin artistik brenda dhe jashtë vendit dhe me një infrastrukturë efektive që siguron edhe dimensionin ndërkombëtar me bashkëpunime, partneritete, rrjete etj.

Realizimi i kërkimit shkencor e artistik të këtij programi studimi doktorature në fushën e artit skenik do të ndihmojë edhe për avancimin dhe krijuar marrëdhënie të reja ndërdisiplinore me insitucionet analoge në rajonin e Ballkanit dhe më tej.

Projektet shkencore e artistike që realizohen nga ky program doktorature do të realizohen në hapësirat e fakultetit dhe të Universitetit të Arteve si studio, atelje, laboratore, boblioteka, arshiva si dhe insitucionet e tjera artistike brenda dhe jashtë vendit.

Gjatësia e programit të ciklit të tretë të studimit të Doktoraturës do të jetë nga 3 deri 5 vite akademike, mbështetur në legjislacionit në fuqi. Studentët doktorantë do të jenë të atashuar edhe part time pranë Departamenteve duke realizuar si pjesën teorike të programit dhe hulumtimin e tyre shkencor e krijues mbi tematikat që lidhen me artet pamore.

Studentët që do të përzgjidhen në programin e ciklit të tretë në doktoraturë duhet të plotësojnë disa kritere hyrëse. Ato shpallen nga departamenti në varësi të specifikave të arteve pamore. Procesi





përzgjedhjes i studentëve kandidatë do të jetë me dosje dhe intervistë e cila do të pasqyrohet në rregulloren e këtij program studimi.

Grupi i udhëheqësve shkencor do të përcaktojë temat hulumtuese e krijuese që do të përzgjedhin studentët e programit të studimit në doktoraturë për të realizuar planin e tyre të kërkimit shkencor. Në tërësi tematikat hulumtuese që do të vendosi grupi udhëheqësve shkencor do të jenë në funksion të realizimit të objektivave kryesore që ka projekti kërkimor që ka ndërmarë Departamenti për realizimin e programit të doktoraturës.


Drejtuesit shkencor do të përcaktojnë qartë platformën e kërkimit shkencor e artistik nëpërmjet planifikimit të metodologjisë së kërkimit shkencor, periudhave kohore të realizimit të hulumtimit doctoral si dhe periudhat e raportimit të ecurisë së punës doktorale.

Element tjetër i rëndësishëm në këtë fazë aplikative të programit është dhe mundësi nga drejtuesit e programit të aktiviteteve referuese e botuese për punimet e studentëve me impaktin e duhur për përmbushjen e standarteve të kriterëve për plotësimin e procedurave të mbrojtjes doktoraturës në fund të periudhës së parashikuar të programit studimit.

Stafi drejtues shkencor i programit do të organizojë konferenca shkencore mbi tematikën e studentëve doktorantë. Studentët doktorantë do të jenë pjesë e kumtesave mbi kërkimin e tyre shkencor dhe krijues të realizuara sipas etapave të përcaktuara në metodologjinë e kërkimit të dakordësuar me drejtuesit shkencor të secilës tematikë studimore. Produktet e prodhuara prej tyre do të jenë objekt i botimeve të artikujve në revista të indeksuara, në përputhje me kriteret e kërkuara.

Drejtuesit shkencor të studentëve doktorant, duke përcaktuar tematikat hulumtuese të realizojnë objektivat dhe qëllimin e programit do të synojnë për realizimin e tematikave kërkimore shkencore dhe projekteve artistike.

Udhëheqja e doktorantëve, është një pikë e fortë për implementimin e këtij programi doctoral. Programi nëpërmjet një marrëveshje përshkruan qartë detyrat e studentit doktorant, udhëheqësit shkencor dhe FAB. Kjo lidhje formon një trekëndësh dhe përcakton të drejtat dhe detyrat e të gjitha palëve. FAB ka një kulturë në procesin e mbikqytjes dhe do të përcaktojë saktë me udhëzime dhe rregulloren e programit përgjegjësitë e secilit, element bazë për shmangien dhe zgjidhjen e konfliktit.



Udhëheqësi doktorantit ndahet nga vlerësimi përfundimtar. Ata do të përqëndrohen në cilësinë e projektit të disertacionit në raport me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program doktoraturë në fushën e artit ndjek standardet e sigurimit të cilësisë dhe procedurat e vlerësimit, të zbatueshme në kontekstin përkatës kombëtar dhe institucional.

Rezultatet e punës së doktorantëve në këtë program studimi do të realizohet me botime, konferenca, vepra artistike, etj.

Ngritja e krijimit të arkivës për disertacionet e këtij programi do të jetë një hap përpara në fushën e ruajtjes dhe publikimit të doktoraturave në fushën e artit. Specifikat e shpërndarjes ose publikimit do të qartësohen në fillim të studimeve të doktoratës duke u përfshirë në marrëveshjen e doktoraturës.

**Misioni** i këtij programi doktorature është të formoj studiues me integritet të lartë profesional, kulturor, qytetar dhe promovues të rolit që ka artet pamore në edukimin e shoqërisë shqiptare

**Qëllimi i programit doktorature** është të pregatisë studiues me njohuri teorike dhe të aftë për të bërë analiza krahasuese duke zhvilluar aftësitë artistike, të gjenerojë njohuri të reja dhe të avancojë në mënyrë të thelluar kërkimet në fushën e arteve pamore, për plotësimin e nevojave të kësaj fushe të krijimtarisë artistike shqiptare me ekspertë, studiues arti dhe kritikë arti, me praktika krijuese bashkëkohore artistike, si dhe staf akademik e mësimdhënës, duke u thelluar në studimin e fenomeneve artistike bashkëkohore shqiptare, krijuesve dhe lidhjen e tyre në një kontekst global me zhvillimet artistike të kohës.

Për të përmbushur këtë qëllim, ky program do të synojë të realizojë **objektivat** në vijim:

- Të sigurojë njohuri të thelluara mbi rreth kërkimit në fushën e artit pamor dhe fenomeneve artistike mbi periudhën e parë që përkon me gjysmën e dytë e shek. XIX dhe deri në gjysmën e dytë të shek. XX.
- Të ofrojë instrumente dhe mekanizma kërkimi shkencorë, që do ndihmojnë në përgatitjen e materialeve, analizave të mirëfillta kërkimore dhe shkencore, të cilat do të sugjerojnë dhe ofrojnë dokumente të cilat do të shërbejnë për të gjitha institucionet apo individët e interesuar.
- Të realizojë projektet hulumtuese brenda një mjedisi që inkurajon të gjithë ata që janë përfshirë dhe i angazhon në bashkëpunime intensive, krijuese shkencore dhe artistike;
- Të konkretizojë njohuritë shkencore me ato artistike, duke çuar drejt prodhimit të vlerave artistike, metodave e strategjive, si edhe analizën teorike të dijeve;



- Të krijojë mundësi të zhvillimit të aftësive bazë të praktikës së kërkimit shkencor e artistik nëpërmjet të hulumtimit shkencor, krijues dhe kritik ndaj krijimtarisë shqiptare me vlera artistike dhe implementimit të kësaj praktike edhe në fusha të ndryshme sociale, kulturore, artistike, etj.

Programi i Ciklit III të studimit “Doktor në Arte Pamore”, kërkon të nxisë dhe formojë thelbin kritik të edukimit doktoral në fushë e arteve. Ai kërkon të zhvillojë dimensione të reja për studentët doktorantë dhe të ofrojë shtylla orientuese në fushat e arteve pamore që janë zhvilluar gjatë dekadave të fundit në Shqipëri dhe rajon por edhe gjatë historisë së vet zhvillimit të arteve pamore. Staf akademik i brendshëm pranë FAB do të jenë përfituesit kryesorë të këtij programi, por edhe studentët do të kenë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ata ndjekin studimet e doktoratës, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:

- Përvetësimin e metodologjive të kërkimit për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarde për referenca, bibliografi, indekse dhe të shkruarit e përmbajtjes si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës;
- Punën e pavarur në laborator/atelje;
- Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe interneti) dhe administrimin e informacionit;
- Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike;
- Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të dhënave;
- Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën kërkimore të doktorantit.

Në kuadër të punës kërkimore shkencore ky program studimi, do të zhvillojë në mënyrë periodike aktivitete shkencore si: konferenca shkencore, tryeza të rrumbullakëta, duke ju dhënë kështu mundësinë doktorantëve të jenë pjesë aktive e jetës akademike dhe kërkimore shkencore. Në këto aktivitete shkencore doktoranti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:

- Ligjërata;
- Debate ndërdisiplinare, të organizuara në kuadër të programit të studimit të doktoratës në Arte Pamore;
- Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të studentëve të postdoktoratës dhe të projekteve kërkimore, madje edhe kur kjo nuk lidhet drejtpërdrejt me interesin e kërkimit të studentit.




Në përfundim të Programit të Ciklit III të studimit “Doktor në Arte Pamore”, çdo student doktorant, do të ketë **outputet** e veta të realizuara në formë materialesh teorike që bartin vlera shkencore, historike, krijuese, analizuese, krahasuese dhe artistike mbi artet pamore shqiptare e më gjerë në rajon si në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, tek Arbëreshët e më tej, me artet pamore në rrafsh ballkanik dhe europian.

**Outputi** që jep realizimi i këtij programi doktorature qëndron tek fakti se do të prodhojë:

- Material teorik si vlerë e shtuar në të gjithë historinë e zhvillimit të artit pamor shqiptar,
- Material teorik në përmirësimin e kurrikulës së programeve Bachelor dhe Master për studentët e arteve,
- Material teorik referues për studiuesit e njohësit e historisë së artit shqiptar,
- Material promovues për personalitete të arteve pamore shqiptare, deri tani jo shumë të përhapura,
- Material teorik ndihmues dhe referues për insitucionet kërkimore e shkencore që punojnë në fushën e arteve,
- Material shkencor, artistik e historik për një publik artdashës, duke plotësuar njohuritë e tij në këtë fushë të arteve,
- Material referues për studiuesit e huaj të së njëjtës fushë dhe pikë referimi krahasuese në analizat e tyre teorike e krahasuese të zhvillimit të historisë së arteve pamore në Ballkan dhe Europë.

## **2. Lloji programit, kohëzgjatja, numri krediteve**

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Arte Pamore kërkon të zbulojë thelbin kërkimor dhe kritik të edukimit doktoral në fushën e arteve pamore. Ai kërkon të ofrojë shtylla orientuese në një fushë që është zhvilluar gjatë dekadave të fundit, por që është ende e re në Shqipëri. Hartimi programit është bazuar te parimet e Firences që përfaqësojnë disa dimensione. Programi doktoraturës ofron një kualifikim që bazohet në njohjen teorike artistike si dhe në zhvillimin e detajuar të një serie tematikash kërkimore dhe artistike që do ndërmeren nga secili student doktorant në kuadër të realizimit të njëprojekti kërkimor artistik në fushën e arteve pamore dhe historisë së artit pamor shqiptar. Realizimi i programit të Doktoraturës në “Artet pamore” në FAB është pa shkoputje të studentëve doktorant nga puna ku ata janë punësuar.



Gjatësia e programit është 3 – 5 vjet konform legjislacionit në fuqi.

### **3.Njësia bazë /njësia kryesore ofruese e programit të studimit bazë**

Programi i ciklit të tretë të studimeve në Doktoraturë në “Artet Pamore” menaxhohet për mbarëvajtjen e tij nga Rektori i UART.

Njësia bazë e zhvillimit të këtij programi doktorature është **Departamenti i Pikturës** që bashkëpunon me departamentet e tjera që janë departamenti i Arteve të Aplikuara dhe Skulpturës në Fakultetin e Arteve të Bukura.

Njësia kryesore është Fakulteti i Arteve të Bukura, pjesë e një prej tre fakulteteve të UART.

Programi i studimit do të ndiqet part time nga studentët doktorantë, të cilët mund të jenë si nga vetë stafi akademik i institucionit por dhe nga insitucionet kërkimore artistike në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë.

### **4. Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes programit.**

UART është i vetmi Universitet në Shqipëri me dy cikle të plota studimi, Bachelor në Arte Pamore, Master në Arte Pamore, e cila ka disa njësi bazë që i dedikohen Njësive Kryesore të këtij Universiteti ku bën pjesë edhe Fakulteti i Arteve Pamore. Në këtë kontekst, nevoja për të patur profesionistë të aftë që t'i përgjigjen këtij realiteti do të sigurohet nga programi i studimit Doktoraturë në Arte Pamore i FAB.

Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Arte Pamore, do të ofrohet nga Njësia kryesore apo Fakulteti i Arteve të Bukura (FAB), i cili është një prej tri fakulteteve të UART. Njësia bazë (departamenti i Pikturës ) do të drejtojë këtë program studimi.

Programi ndërtohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat e përcaktuara në bazë të drejtimeve: a) Arte të aplikuara; b) Pikturë; c) Skulpturë. Studentët e këtij programi doktoral janë strategjikisht të rëndësishëm për zhvillimin e cilësisë së përgjithshme akademike të FAB. Kohëzgjatja e këtij programi studimi është jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të programit të studimit, lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor” në Arte pamore.



Programi doktoral “Doktor në Arte Pamore” vjen si një nevojë e kahershme e plotësimit të ciklit edukativ akademik në fushën e arteve pamore në Shqipëri. Prej shumë vitesh tashmë, kjo nevojë ka qenë e pranishme, e lidhur ngushtë me mungesën e kërkimit shkencor, kritikës, ekspertizës profesionale dhe, në përgjithësi, rritjes së nivelit akademik dhe shkencor të stafit mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Bukura.

Programi doktoral në “Artet Pamore” është krijuar për të fuqizuar akademikët dhe profesionistët e angazhuar në fushat e kërkimeve shkencore akademike, të përqendruar në çështjet që lidhen me lëmin e: arteve të aplikuara, pikturës dhe skulpturës. Ky program studimi kërkon të sigurojë studime të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e fenomeneve artistike në Artet Pamore, për t’i përgatitur studentët për avancim akademik, kërkimor, si dhe karrierë të avancuar profesionale. Përfundimi me sukses i gradës shkencore “Doktor në Arte Pamore” kërkon nga çdo doktorant realizimin e një marrëdhënie të sofistikuar me dijen dhe kujdesin për krijimin e një identiteti intelektual. Në përfundim, studentët janë të aftë të identifikojnë një traditë specifike të kërkimit shkencor dhe metode kërkuese që përputhet me angazhimet e tyre.

Plotësimi i tre cikleve të studimit në Universitetin e Arteve është, në radhë të parë, një domosdoshmëri e kërkuar qartë nga ligji i MASR për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Shqipëri. Në fushën e arteve pamore mungojnë kritikët e artit, kuratorët, gazetarët e kulturës dhe studiuesit e artit në përgjithësi, duke krijuar një boshllëk të konsiderueshëm në studimin e fenomeneve të reja prezente në këtë fushë, por edhe në evidentimin dhe adresimin me nivel profesional dhe shkencor të momenteve të ndryshme të zhvillimit të artit shqiptar historikisht. Gjithashtu ndjehet një mangësi në botimet shkencore, monografite apo studimet e problematikave të reja bashkëkohore mbi zhvillimet në skenën bashkëkohore të arteve pamore në Shqipëri.

Kjo kërkesë për hapjen e Programit të Doktoraturës në FAB të UART, bazohet në disa parime strategjike dhe në disa modele për organizimin e programeve të doktoraturës nga universitetet e artit në Europë dhe SHBA. Ndryshueshmëria në insitucional të universiteteve të artit ndikon që zbatimi i programeve të doktoraturës në fushën e arteve t’i nënshtrohet proceseve dhe normave rregulluese të ndryshme. Disa vende si, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Suedia, Spanja, kanë dhjetë ose më shumë vite përvojë në dhënie të gradave të doktoraturës në fushën e arteve. Ndërsa vende të tjera kanë filluar të prezantojnë studimet e doktoraturës, vetëm gjatë viteve të fundit. Meqenëse legjislacioni i shteteve të ndryshme ka ndryshime në lidhje me procedurën e hapjes së programeve të studimeve kërkimore të doktoraturës në fushën e arteve dhe *art design-it*, mund të flitet sot për një Evropë me shpejtësi të ndryshme në këtë drejtim. Gjithashtu, disa vende kanë futur

programet e doktoraturës në fushën e artit, si pjesë e programeve studimore bashkëpunuese me universitete shkencore, si p.sh.: Zvicra dhe, pjesërisht, Belgjika.

Universitetet e artit kanë qenë në gjendje të implementojnë programet e doktoraturave artistike si një e drejtë e tyre, pa pasur nevoja për bashkëpunim (Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Finlanda, Austria, Republika Çeke).

Diskutimet rreth doktorave në fushën e arteve, të udhëhequra nga universitetet e artit apo dhe organizata të tjera, kanë treguar, pavarësisht dallimeve strukturore, se ka një motivim në rritje për të ofruar programe doktorature në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Kjo rritje e motivimit përkon deri në një farë mase, me zhvillimin masiv në disiplinat artistike të kërkimit shkencor artistik brenda fushave të artit. Ndiheza për menaxhimin e kësaj prirje motivuese drejt kërkimit në doktoraturat në fushën e arteve organizohet nga disa organizata ndërkombëtare me fokus hulumtimin artistik në mbarë Evropën. Të tilla janë p.sh. Rrjeti Evropian i Kërkimeve Artistike (EARN), Shoqata për Hulumtime Artistike (SAR), Hulumtimi Artistik i Platformës Europiane në Muzikë (EPARM), etj. Krahas këtyre organizatave ndërkombëtare, ka dhe disa organizata kombëtare që ndihmojnë në këtë drejtim si p.sh.: Platforma për Kërkime Artistike në Suedi (PARSE), apo disa revista që ndikojnë për shpërndarjen e rezultateve të kërkimit artistik, të tilla si p.sh. Revista JAR për Hulumtime Artistike. Kjo veprimtari në funksion të rritjes së kërkimit artistik brenda artit mbështetet nga disa programe financimi për projekte kërkimore artistike si p.sh.: Programi PEEK në Fondet Shkencore Austriake, Programi Norvegjez i Kërkimeve Artistike dhe programi financues për kërkime artistike në Këshillin Suedez të Kërkimeve.

Hapja e programeve të doktoraturës në fushën e arteve është formuluar si një pikë referimi për politikbërësit, drejtuesit e universitetit, hartuesit e kurrikulave dhe agjencitë për financimin e kërkimit. Kërkesa për hapje ndihmon universitetet e artit së pari për të siguruar njohje për përpjekjet e tyre me organet kombëtare të financimit, ligjet etj. dhe së dyti i ndihmon për të mësuar rreth nivelit të implementimit të zhvillimit të kërkimit shkencor brenda universiteteve të artit. Inisiativa për të hartuar një program doktorature në fushën e arteve ka ardhur si pasojë edhe e përfshirjes së "kërkimit shkencor artistik" në Manualin e Frascatit të OECD-së. Ajo ka për qëllim formimin e mëtejshëm të të kuptuarit të hulumtimeve në fushën e artit dhe krijimin e kornizave, mjediseve dhe burimeve të nevojshme për pjesmarrësit e programit të doktoraturës, me qëllim zhvillimin e projekteve të tyre. Ky manual bëri të qartë se gjithçka që vlen për hulumtimin dhe hapjen e programeve të doktoraturës në fushën e artit bazohet në disa dokumenta kryesor siç janë: "Rekomandimet e Salzburgut" (2005) organizuar Shoqata Europiane e Universiteteve (EUA) dhe "Trajnimi inovativ i doktoraturës" (Komisioni Evropian), dokumenta ku mbështetet edhe inisiativa për hapjen e këtij programi të parë në fushën e artit në IAL shqiptare.



Programi i studimit “Doktor në Arte Pamore” vjen si një nevojë e domosdoshme e plotësimit të ciklit edukativ akademik në fushën e arteve pamore në Shqipëri. Prej shumë vitesh tashmë, kjo nevojë ka qenë e pranishme, e lidhur ngushtë me mungesën e kërkimit shkencor, të kritikës, të ekspertizës profesionale dhe, në përgjithësi, të rritjes së nivelit akademik dhe shkencor të stafit mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Bukura.

## **5. Analiza SWOT e aplikimit për hapje programi**


Nisma e Fakultetit të Arteve të Bukura për hapjen e Programi i Ciklit të Tretë Doktoraturë në Arte Pamore mbështetet edhe në ekzistencën prej vitesh të programeve të ngjashme në universitete europiane, si edhe (siç u theksua më lart), si një nevojë e brendshme për çeljen për herë të parë të një programi studimesh të Ciklit III në fushën e arteve pamore, me synim kryesor përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për menaxhimin e problematikave në lidhje me politikat kulturore, kritikën e arteve pamore, historinë e artit etj. Nisur nga përvoja jonë, kjo fushë studimore që do të mbulojë ky program është thujtë e zbrazët në Shqipëri, andaj mendojmë se ka shumë rëndësi të mos humbasim edhe më shumë kohë, por të vendosim bashkërisht mbylljen e këtij boshllëku.

### **5.1. Analiza SWOT**

Analiza SWOT e programit të studimit Doktoraturë “Në Artet Pamore” na ndihmon të “jemi me këmbë në tokë”. Ajo sqaron pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe sfidat e këtij programi. Le ta analizojmë dhe të renditim argumente e fakte në lidhje me këtë program.

#### **2. Pikat e forta për programit**

Analiza SWOT na ka mundësuar që të shqyrtojmë këtë sistem në tërësi dhe në kompleksitetin e tij. Analiza SWOT na orienton se cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të këtij programi studimi, cilat janë mundësitë që mund të çojnë në ndërtimin e këtij programi, që do të na ndihmojnë t'i shndërrojmë sfidat e tij në mundësi, në mënyrën më të mirë të mundshme. Analiza SWOT, që kryem, na mundëson që objektivisht politikëbërësit, akademikët në universitetet dhe institucionet kërkimore në fushën e artit të arrijnë në përfundimin se ky program është i nevojshëm për të përballuar kërkesat e sotme dhe të perspektivës të studimeve teorike në fushën e arteve pamore, si





edhe për studime krahasuese teorike e praktike mes zhvillimeve të kësaj fushe në Shqipëri, shkollat e rajonit dhe, më gjerë, me ato europiane.

- Institucioni dëshmon se funksionon në përputhje me parashikimin e statutit dhe rregulloreve të tij brendshme;
- Ecuri e mirë në procesin e akreditimit institucional dhe atë të programeve të studimit;
- Njësi kryesore dedikuar Arteve Pamore;
- Kurrikul cilësore dhe fleksibël në të dy ciklet e studimit, e cila siguron përgatitjen cilësore dhe përputhje me kërkesat e tregut;
- Interes në rritje në të tre ciklet e studimeve në profilin Arte Pamore;
- Projekte kërkimore shkencore, të lidhura ngushtë me fenomenet artistike dhe historike;
- Krijimi i mundësive dhe hapësirave për përfshirjen në procesin e kërkimit shkencor dhe në jetën akademike e mësimore të studentëve të ciklit të tretë;
- Kurrikul e pasur dhe në përputhje me nevojat për formimin teorik dhe praktik të studentëve;
- Personeli akademik i kualifikuar dhe me profil në përputhje me objektivat e programit studimor e bën këtë program mjaft tërheqës për studentin. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka grada e tituj akademik, në përputhje me përcaktimet ligjore, eksperiencë në mësimdhënie dhe përvojë profesionale në fushën përkatëse.
- Kushtet infrastrukturore të UART përbëjnë një avantazh absolut për ofrimin në kushte optimale të programit studimor.

Analiza SWOT e programit të studimit “Doktor në Artet Pamore”na ndihmon të dallojmë pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe sfidat e këtij programi

### **3. Pikat e dobët të programit**

1. Është programi i parë që hapet.
2. Teknologjinë digjitale dhe software të përparuara duhet të përvetësohen nga studentët doktorantë.
3. Burime minimale financiare për organizimin e aktiviteteve shkencore dhe artistike, por që do të përballohen me sukses, për të mundësuar studentët që të afirmojnë punën e tyre kërkimore dhe artistike.
4. Përvoja e pakët së eksperiencës së udhëheqësve të doktoraturës.

### **4.Mundësitë e programit**



Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Departamentet tona ka një staf akademik të aftë të ofrojë zhvillimin cilësor të programit, duke ndikuar për zhvillimin e kesaj fushe studimi në artin shqiptar.

Cilësia e Programit të Ciklit të Tretë Doktoraturë në Arte Pamore mund të analizohet realisht në nivelin funksional, në fund të vitit të parë të implementimit të tij.

Literatura e ofruar është ose në gjuhë të huaj, ose e përkthyer në shqip, sipas tërë rregullave të botimit, por ekzistojnë edhe libra të përgatitur nga personeli akademik i fakultetit, të cilët janë në përdorim mbarëkombëtar për shkak të cilësisë së përmbajtjes dhe ndikimit në formimin teorik e profesional.

Përdorimi i teknologjisë digjitale në aktivitetin shkencor e artistik të studentëve doktorantë do të ketë efekt në punën e tyre kërkimore. Departamenti mund të bëjë më shumë aktivitete shkencore, ku studentët do të jenë pjesë e referimeve në keto aktivitete.

Qasje në shfrytëzimin e burimeve të literaturës në bibliotekën e fakultetit por edhe ato *online*.

## **5. Sfidat programit**

- Studentët që përfundojnë programin Doktoraturë në Arte pamore, mund të largohen nga ndjekja e kesaj rruge kualifikuese për shkaqe të ndryshme dhe shkon dëm investimi i fakultetit.
- Sipas rregullores programi do të jetë part time ku studentët do të vazhdojnë punën e tyre dhe do ndjekin programin. Do të merret leja nga punëdhënësi i tyre për këtë angazhim të studentëve në program ?
- Tarifa e studentëve kërkon gjenerimin e fondeve nga FAB nëpërmjet aplikimeve në projekte kombëtare e ndërkombetare . Sa do realizohet kë komponentet për të ulur barrën e tarifës së studentëve?
- Për shkak të cilësisë së programit që ofrohet ka një numër të kufizuar studentësh që mund të regjistrohen në këtë program dhe mund të ketë rënie të numrit të studentëve që do të kërkojnë të futen në këtë program dhe për vetë natyrën specifike pasi kërkon studentë shumë cilësor.
- Literatura në shërbim të studentëve duhet të jetë bashkëkohore dhe të pasurohet me shpejtesi nga biblioteka apo dhe burime të tjera dhe a do të jetë në kohën e duhur në shërbim të studentëve?

## **6. Përfundim**



Departamenti Pikturë ka ndërtuar një program studimi bashkëkohor që mungon në IAL shqiptare. Departamenti dhe FAB ka personel akademik me reputacion dhe kontribute kombëtare e më gjerë në fushen e arteve pamore, me veprimtari të pasur akademike e profesionale.

## **B. Të dhëna mbi kriteret e pranimit, tarifa dhe modalitetet financiare**

### **1. Kriteret e pranimit në programin e studimit**

Programi synon të jetë një program elitari. Kandidatë që do të hyjnë në këtë program doktore do të plotësojnë kërkesat formale të përcaktuara nga Departamenti Pikturë, bazuar në kualifikimet dhe kompetencat e tyre artistike.


Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës që nënkupton vlerësimin tërësor të treguesve të kandidatit që përfshijnë arritjet akademike, përputhjen e interesave të kandidatit me qëllimet e programit, nivelin e zotërimit të gjuhës huaj , nivelin e rekomandimit.

Studentët për të ndjekur këtë program studimi mund të pranohen nga Shqipëria, Kosova, Preshevë-Bujanovca, Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi si dhe nga vende të tjera nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe dhe një gjuhë të huaj të çertifikuar nga insitucionet përgjegjëse. Në përputhje me këtë synim pranohen kandidatë që kanë rezultate të larta në studimet universitare bachelor dhe master të kësaj fushe si dhe impakt të mirfilltë me spektatorin e teatrit me veprat e tyre në skenë si brenda dhe jashtë vendit.

Kandidatët do të pranohen nëpërmjet shqyrtimit të dosjeve dhe me intervistë.

Dokumentacioni është:

- a) Formular i plotësuar i kërkesës.
- b) Certifikatë lindjeje me fotografi.
- c) Diploma universitare bachelor dhe master me notë mesatare 8.5, e shoqëruar, me listën e notave, noteruar dhe e shoqëruar me origjinalen.
- d) Diploma ose certifikata të kualifikimeve të ndryshme me listën e notave, të noteruara dhe shoqëruar me origjinalen.
- e) Dëshmi i zotërimit të gjuhës së huaj e noteruar dhe e shoqëruar me origjinalen.



- f) Listë botimesh apo referimesh shkencore e shoqëruar me fotokopje të kopertinave të botimeve dhe abstrakteve të tyre.
- g) Lista e aktiviteteve artistike figurative që mund të ketë kryer studenti doktorant, bazuar mbi dokumentacionin përkatës (postera, fletëpalosje, kritika nështypin periodik etj).
- h) Letrave të rekomandimit dhe dosjes së krijimtarisë artistike të tij.
- i) 3 (tri) fotografi 3.5x 4.5 cm
- j) Fletëpagesa e taksës së regjistrimit për konkurrim.
- k) Një prospekt i projektit kërkimor që do të ndërmarrë studenti doktorant i cili vlerësohet në funksion të fushave të kërkimit të programit, si edhe kompetencave dhe burimeve të tij për ta realizuar këtë projekt.

Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritokracisë që do të thotë vlerësim tërësor i treguesve të kandidatëve që do të përfshijnë arritjet akademike, përputhjen e interesave të kandidatit me qëllimet e programit të studimit doktorant, nivelin e zotërimit të gjuhës së huaj dhe nivelin e rekomandimit.

## 2. Fusha e studimeve paraardhëse

Fushat e studimeve paraardhëse për hyrjen në programin e doktoraturës janë programet master në fushën e artit në drejtimin Pikturë, Grafikë, Skulpturë, Tekstil Modë, Qeramikë, Fotografji, Multimedia nga universitetet publike e private në Shqipëri dhe në trevat shqipfolëse në Kosovë, Maqedoni e Veriut, Malin e Zi etj .

## 3. Numri maksimal i studentëve


Numri maksimal i studentëve që mund të pranohen në këtë program studimi Doktoraturo në vitin shkollor 2023 – 2024 do të jetë e pranueshme 15 studentë. Ndërsa numri minimal i studentëve për hapjen e programit do të jetë 10 studentë.

## 4. Tarifa e studimit

Tarifa e shkollimit për një student doktorant do të jetë afërsisht **507, 350 lekë**. Kjo tarifë do të jetë e ndarë në tri vite studimi. Shpenzimet e programit janë të lidhura me fazën hulumtuese si dhe me fazën realizuese dhe udhëheqëse që kërkohet për të realizuar plotësimin e tematikave hulumtuese nga studentët doktorant.

Vlera financiare e projektit në 3 vite shkollore do të përfshijë mbulimin e këtyre zërave:

Nr.	Emërtimi	Ore	Lek/ore	Numri i	TOTALI
-----	----------	-----	---------	---------	--------



		student		studentëve	(lek)
1	Udheheqje teze doktrate (3 vite)	270	1,390	1	375,300
2	Recense	15	1,390	1	20,850
3	Oponence teze doktorature	25	1,390	1	34,750
4	Kryetar i jurise i doktoratures	15	1,390	1	20,850
5	Anëtar te jurise se doktoratures (4 vete x10 ore)	40	1,390	1	55,600
6	<b>TOTALI PËR (1) STUDENT</b>	<b>335 orë</b>			<b>507,350</b>

- *Për uljen e shpenzimeve do të aplikohet udhëzimi nr.29, datë 10.09.2018 i MASR.*
- *Organizimi dy konferencave shkencore nga burime alternative të kandidatëve.*
- *Pjesmarje aktivitete shkencore dhe botime artikujsh shkencor, nga vetë kandidatët.*
- *Lëvizje, dieta, kancelari, material konsumi në shërbim të temës etj. nga vetë kandidatët.*

**Totali i kostos së programit për student është 507,350 ALL.**

Tarifa për një student doktorant është afërsisht **507,350 ALL.**

Tarifa financiare do të mbulohet:

- **507,350** lekë nga vetë kandidati në kuadër të pagesës së shkollimit e ndarë kjo në tri këste me nga 170 000 lekë për çdo vit shkollor.
- 20 000 lekë nga burimet financiare nga vetë FAB në kuadër të të ardhurave nga të tretët të planifikuara për kërkimin shkencor në buxhetin e UART
- 20 000 lekë nga burime financiare nga marëveshjet që janë nënshkruar me Ministrinë e Kulturës që në kuadër të paktit për universitetin të financohet edhe për realizimin e projekteve kërkimore e krijues.

Politika të mbështetjes financiare për studentët për lehtësimin e pagesave të shkollës së doktoraturës do të jetë:

- Një kuotë do të jetë për studentët e kategorive të vecanta dhe do të mbulohet e gjithë tarifa e doktoraturës nga FAB.



- Ndhimesë financiare nga aplikimi në grantin për projekte që ka MASR ku mund të financohet si insitucion.
- Ndhimesë financiare nga burime pranë axhensive që ofrojnë financime për projekte kërkimor e shkencor në fushën e artit dhe shkencës.
- Ndhimes financiare nga fondet e fituara nga aplikime në axhensi apo fondacione private që janë në shërbim të zhvillimit të artit shqiptar.

Burimet kryesore financiare të projekti për periudhën tri vjecare të funksionimit të tij do të jenë:

- Burimet financiare nga vetfinancimi programit doktoraturës që realizohet nga studentët doktorantë.
- Burime financiare nga FAB në kuadër të të ardhurave nga të tretët të planifikuara për kërkimin shkencor në buxhetin e UART.
- Burime financiare nga marrëveshjet që janë nënshkruar me ministrinë e Kulturës që, në kuadër të “Paktit për Universitetin”, të financohet edhe realizimi i projekteve kërkimore e krijuese.
- Burime financiare nga aplikimi në grantin për projekte që ka MASR, ku ky projekt mund të financohet në rang insitucioni.
- Burime nga aplikime pranë agjensive që ofrojnë financime për projekte kërkimore e shkencore në fushën e artit dhe shkencës.

Nga aplikime nga agjensi apo fondacione private që janë në shërbim të zhvillimit të artit shqiptar.

## **C. Plani mesimor /Kurrikula e programit të studimit**

### **1. Nuk aplikohet**

### **Ç. Personeli akademik dhe ndihmës akademik**

Stafi akademik për realizimin e programit të doktoraturës është përzgjedhur nga personalitete artistike dhe shkencore të departamenteve të FAB.

Stafi akademik që do të udhëheqi kërkimi shkencor e artistik do të realizojë analizën teorike e praktike të një serie tematikash me karakter artistik e krijues në fushën e arteve pamore. Stafi akademik është i kategorisë professor dhe ka të gjithë përgatitjen e duhur shkencore dhe artistike për të marrë nën udhëheqje studentët doktorantë.



Stafi akademik që do të udhëheqi kërkimi shkencor e artistic do të realizojë analizën teorike e praktike të një serie tematikash me karakter artistik, historik e krijues në fushën e zhvillimit të shkollës së artit shqiptar. Kjo do të trajtohet në njëvështrim krahasues me ecurinë e historisë së artit shqiptar përgjatë ecurisë së tij.

Ky staf akademik do të ofrojë ekspertizën e duhur shkencore dhe artistike për realizimin e temave kërkimore në fushën që mbulon programi doktoraturës. Stafi akademik është i kategorisë akademik dhe profesor dhe ka të gjithë përgatitjen e duhur shkencore për të marrë në udhëheqje nga një student doktorant në këtë program studimi. Produkti i prodhuar do të ketë vlerat e tij shkencore, artistike, dhe historike dhe do të jetë një material me vlerë për artin pamor shqiptar.

Numri i stafit akademik të njësisë bazë që është departamenti Pikturë, Skulpturë dhe Arte të Aplikuara (4 pedagogë).

Numri i personelit akademik në këtë program studimi është si më poshtë:

Lista e stafit akademik realizues të këtij programi është:

Personeli akademik me kohë të plotë	Titulli / grada	Institucioni IAL	Departamenti / qendra/ njësia kryesore	Spektori mësimor/ kërkimor
Gazmend Leka	Prof.	U. Arteve –FAB	Pikturë - FAB	
Najada Hamza	Prof.	U. Arteve –FAB	Arte të Aplikuara - FAB	
Artan Peqini	Prof.	U. Arteve –FAB	Skulpturë - FAB	
Sadik Spahija	Prof.	U. Arteve –FAB	Skulpturë - FAB	
Vladimir Myrtezaj	Prof.	U. Arteve –FAB	Pikturë/Multimedia - FAB	
Ardian Isufi	Prof. Asc. Dr	U. Arteve –FAB	Arte të Aplikuara - FAB	
Albes Fusha	Prof. Asc.	U. Arteve –FAB	Arte të Aplikuara - FAB	
Edmond Gjipopulli	Prof. Asc.	U. Arteve –FAB	Pikturë - FAB	
Anila Mullahi	Prof. Asc. Dr	Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë	

#### D. Infrastruktura akademike në funksion të IAL së degës së njësisë kryesore.



Nr	Pershkrimi	Sasia
1	iMAC 21.5"	6
2	iMAC PRO	2
3	MAC Mini	2
4	ËACOM 27"	2
5	Aksesor per Mac 1 Draëing Tablet	5
6	Aksesor per Mac 2 Pro-Draëing Tablet	5
7	NAS MAC	1
8	Scanner 3D	1
9	Printer 3D	1
10	Printer Filament (bardh)	10
11	Printer Filament (gri i erret)	5
12	Printer Filament (jeshil)	5
13	Scanner	1
14	Projector 7000 Lumens	1
15	Hardëare per capture and playback 4K	1
16	Green Screen	1

Biblioteka është bibliotekë online si dhe është me një numër shumë të madh titujsh akademik në fushën e artit si dhe ka mbi 60 poste leximi dhe është një ambient komod që I përmbush kushtet e një biblioteke modern në shërbim të studentëve doktorant

#### **E. Programet e përbashkëta**

Ky program nuk është program i përbashkët me ndonjë insitucion tjetër të arsimit të lartë as vendas dhe as i huaj.

#### **F. Analiza e tregut të punës**

Fakulteti i Arteve të Bukura mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe të punësuar në insitucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dhe që prodhojnë vlera artistike në tregun shqiptar dhe të huaj.

Një formë frutëdhënëse e këtij bashkëpunimi në kërkim të tregut të punës janë aktivitetete artistike individuale në ekspozita të ndryshme brenda dhe jashtë Universitetit të Arteve. Këto aktivitetete





përfshin mbajtjen e kontakteve ku në cdo ekspozitë të FAB ka pjesëmarrjen e ish studentëve që kanë përfunduar specialitetin pikturë, grafikë, multimedia, skulpturë etj.

Gjithashtu FAB mban kontakte me studentët Alumni që kanë mbaruar programet master në fushën e Pikturës, Grafikës, Skulpturës, tekstil – modës, qeramikës, multimedias etj, të cilët janë kandidatë për këtë program studimi Doktorature.

Nga analiza e tregut të punësimit të kësaj kategorie studentësh vihet re se shkalla e punësimit të tyre është e mirë.

Ata janë të punësuar:

- në institucione arsimore të arsimit parauniversitar, Tiranë dhe rrethe, rreth 50 % e e tyre.
- në MK, Tiranë.
- në institucione kërkimore si QSPA , Galeri, Muze Kombëtar, AKSA etj.
- në televizionet kombëtare dhe lokale.
- në administratën shtetërore dhe lokale.
- në qendra të kërkimit në fushën e artit.
- në sektorin privat dhe në kompani design.
- Si krijues të lirë, 100 %.
- Etj.

Ky kontigjent studentësh do të jenë prurjet me student që do të aplikojnë në programin e doktoraturës.

Punësimi i studentëve që do dalin nga programi Doktoraturës, meqënëse është një kontigjent i vogël specialistësh do të kenë të garantuar për një periudhë kohore mbi 10 vjet punësimin e tyre sepse ky është një specialitet i ri që ka nevojë për këtë shkallë kualifikimi në Shqipëri. Ata me shkallën e kualifikimit mund të punësohen në disa fusha ku mund të përmendim:

- Në institucionet e arsimit të lartë si staf akademik në edukimin artistik të studentëve shqiptar në UART apo dhe në IAL e tjera që realizojnë përgatitjen e studentëve të ciklit bachelor dhe master në fushën e artit pamor.
- Në Qendra dhe institucionet kërkimore si specialistë në fushën e kritikës së artit pamor dhe të historisë së artit pamor.
- Në institucionet e administratës shqiptare për hartimin e strategjive dhe politikave në fushën e arteve pamore.
- Në sistemin e dokumentacionit bibliotekar në fushën e artit për të promovuar edukimin artistik.
- Në sistemin e arsimit parauniversitar për të ndihmuar kualifikimin e trupës pedagogjike që punon në fushën e historisë së artit pamor.
- Në kompani dhe institucione private që janë të fokusuar në studime dhe aplikime në fushën e artit pamor.
- Në institucione apo organizma të ndryshme ndërkombëtare që janë në Shqipëri dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e politikave të arteve pamore.




IAL-të, përfshirë edhe Universitetin e Arteve, sipas legjislacionit në fuqi, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë akademike dhe asaj kërkimore, kanë si domosdoshmëri ekzistencën e stafit akademik dhe/ose kërkimor të kualifikuar. Në këtë kontekst, kërkesa e vazhdueshme për personel të kualifikuar në shkallën më të lartë është domosdoshmëri dhe parashikohet të vijë në rritje, qoftë si nevojë e rifreskimit të stafit akademik, ashtu edhe sa i përket pranimeve të reja. E njëjta situatë, në vija të përgjithshme, parashikohet edhe për vende të tjera të rajonit e, sidomos, për territoret shqipfolëse. Përcaktimet e mësipërme i bazojmë edhe në pritshmëritë dhe mbështetjen që ky program do të ketë ndaj shtetasve me kombësi shqiptare, por që jetojnë përtej kufijve. Rrjedhimisht, hapja e programit të doktoraturës në arte pamore, në bashkërendim me projektet kërkimore të stafit akademik do të mund të rrisë ndjeshëm veprimtarinë kërkimore shkencore të kësaj fushe dhe do të adresojë problematikat lidhur me tregun e punës, sipas sqarimeve të mësipërme.

Hapja e Programit të Ciklit të Tretë të studimeve Doktoraturë në Artet Pamore, propozuar nga FAB/UART bazohet edhe në disa dokumente mjaft të rëndësishëm si “Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë<sup>1</sup> ku shprehet edhe për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe Strategjisë Kombëtare për Kulturën (SKK 2019-2025)<sup>2</sup> ku në misionin dhe objektivat e saj shprehet mbi nxitjen dhe përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave të mira.

Masat për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e Arteve Pamore kanë si qëllim ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, për t’iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave jo vetëm të zhvillimit të sektorit të artit pamor, por edhe të trendeve bashkëkohore të tij. Ky program studimi ka mundësi të mira në tregun e punës, pasi siç e kemi theksuar, institucionet e fushës kanë shumë nevojë për studiues dhe specialistë të kualifikuar. Studentët do të aftësohen nëpërmjet punës kërkimore shkencore dhe do të jetë kërkimi shkencor ai që do të mundësojë edhe rritjen profesionale të tyre, nën drejtimin dhe tutorimin e profesorëve të fushës. Kërkimi shkencor në fushën e arteve pamore shqiptare kërkon profesionistë të mirë e të kualifikuar, të aftë që t’u japin përgjigje shumë pyetjeve që shtrohen para arteve pamore në përgjithësi e, sidomos, asaj shqiptare në veçanti. Tregu kërkon studiues të specializuar që të thonë fjalën e tyre për historikun, drejtimet, zhvillimet, mangësitë e rrugën nëpër të cilën kalojnë artet pamore shqiptare. Tregu ka nevojë për

<sup>1</sup><http://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor>

<sup>2</sup> Strategjia Kombëtare e Kulturës 2019-2025.. fq. 2, fq. 28 -objektivi 6, fq. 30 –objektivi 7 , fq. 37 –objektivi 8:  
<https://kultura.gov.al/ep-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf>



specialistë që të thonë fjalën e tyre bazuar në dije e kritere shkencore.

Mundësitë për punësim janë edhe në arsim si mësues e pedagogë të fushës. Janë institucionet kulturore të parat, që do të jenë të interesuara për studiuesit e doktoruar. Janë mediat që do të kërkojnë mendimin e specializuar në hapësirat e tyre kushtuar arteve pamore. Janë bizneset private që kanë nevojë për t'u orientuar në art.

Departamenti i Pikturës në bashkëpunim me departamentin e Arteve të Aplikuara dhe departamentin e Skulpturës në Fakultetin e Arteve të Bukura, në bashkëpunim edhe me dy fakultetet e tjera, që ofron programe studimi në fushën e arteve pamore dhe, si rrjedhojë, i takon atij të marrë masat për plotësimin e këtij boshllëku në fushën e studimit dhe krijimit shkencor në artet pamore.

Bashkëpunimi i FAB me institucione dhe Universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, janë një aset i vyer i këtij fakulteti, jo vetëm në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, por edhe në atë të rritjes së tregut të punës për studentët e tij të kualifikuar.

Grupi i studentëve të ciklit të dytë të studimeve “Master në Arte Pamore dhe Mësuesi” kanë mundësi për t'u punësuar në sektorë të ndryshëm që lidhen me Artin Shqiptar dhe Trashëgiminë Kulturore Shqiptare, si edhe për të avancuar studimet e tyre të thelluara në fushën e Arteve Pamore, një kërkesë e tyre për të vijuar edukimin me qëllim arritjen e profesionalizmit në këtë fushë.


Programi doktoral në fushën e Arteve Pamore do të jetë një vlerë e shtuar në mbulimin e kapaciteteve njerëzore me ekspertizë të zgjeruar për plotësimin e nevojave në këtë fushë. Në kuadër të organizimit të programit të studimit doktoraturë në fushën e Arteve Pamore,

Departamenti i Pikturës ka ndërmarrë iniciativën e hartimit dhe shpërndarjes së 3 pyetësorëve.


- Për studentët e ciklit të dytë të studimeve të FAB.
- Për të diplomuarit në doktoraturë në fushën e Arteve Pamore.
- Për punonjësit që punojnë dhe japin kontributin e tyre në fushën e Arteve Pamore kryesisht në prefektura, bashki dhe ministri etj.

Ndër studentët e ciklit të dytë u pyetën rreth 100 studentë dhe rezultatet e përgjigjet të tyre jepen në grafikët e mëposhtëm.


**a) Pyetësor zhvilluar studentët e ciklit të dytë të studimeve të FAB**



A mendoni se orientimi i punës kërkimore të doktorantit përmes projekteve kërkimore të hartuara nga departamenti krijon lehtësira...





A mendoni se doktora në Arte Pamore do të sillte mundësi punësimi dhe karrierë?



a) Pyetësor zhvilluar më doktorantë që kanë mbaruar doktoraturën






**b) Pyetësor i zhvilluar më doktorantë që japin kontributin e tyre në sektorë të ndryshëm në fushën e Arteve Pamore.**




A mendoni se zhvillohet mjaftueshëm kërkimi shkencor në Shqipëri për Artet Pamore?



■ aspak dakord ■ disi dakord ■ neutral ■ mjaftueshëm dakord ■ plotësisht dakord


A mendoni se do ta kryenit më mirë punën Tuaj nëse do të thelloheshit më shumë nga ana shkencore në studimin e fenomeneve artistike dhe zhvillimit historik të Arteve Pamore?




■ aspak dakord ■ disi dakord ■ neutral ■ mjaftueshëm dakord ■ plotësisht dakord




A mendoni se puna Juaj paraqet mjaftueshëm specifika për të patur nevojën e edukimit më vete në të gjitha ciklet, veçanërisht ciklin doktoral?



A mendoni se studimet e thelluara në doktoraturë në Arte Pamore do t'ju shërbenin dhe përgatisnin më mirë për sfidat e reja që ju presin në aspektin profesional?



Nga të dhënat e mësipërme arrijmë në konkluzionin se ka një nevojë të perceptuar për studime të thelluara në fushën Arte Pamore. Një e dhënë tjetër shumë pozitive është fakti se doktoratura në fushën Arte Pamore shihet të këtë një ndikim në krijimin e mundësive më të mira të punësimit dhe ecurisë në karrierë. Nga ana tjetër, studentët që janë diplomuar në doktoraturë në fushën Arte Pamore, shprehen se programi do të zhvillojë pritshmëritë e tyre. Interesante janë edhe përgjigjet nga punonjësve të cilët japin koontributin e tyre në institucione të ndryshme, arsimore apo kulturore, të cilët shprehen në një masë mjaft të lartë rreth 60% se në këto institucione ka hapësirë



për kërkim shkencor dhe jo vetëm, por rreth 70% e të pyeturve janë përgjigjur se realizimi i doktoraturës në fushën Arte Pamore do t'i ndihmonte të bëjnë më mirë punën e tyre. Në përfundim, punonjësve në institucione të ndryshme administrative, arsimore apo kulturore, të cilët përballen me sfidat e reja të Artit, Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore në procesin e globalizimit dhe integritimit në Bashkimin Europian, u është bërë pikërisht pyetja nëse do t'i shërbente kjo doktoraturë përgatitjes së tyre për t'u përballur më mirë me këto sfida, rreth 54% e tyre janë përgjigjur pozitivisht.

Në përmbledhje të informacionit të marrë nga pyetësorët, mund të arrihet në konkluzionin se programi i studimit Doktoraturë në Arte Pamore, fiton identitetin e tij, qoftë në identifikimin e nevojës për të, por edhe në tregun e punës. Gjithashtu duke ju referuar nivelit të përgjigjeve mund të themi që programi i studimit Doktoraturë në Arte Pamore, rezulton të jetë i lidhur pozitivisht me ecurinë në karrierë të individëve në institucione të ndryshme administrative, arsimore apo kulturore, dijeve dhe përmirësimit të performancës individuale të tyre. Po ashtu reagim pozitiv ka edhe për formën e organizimit dhe orientimit me projekte kërkimore shkencore të programit të doktoraturës.

